

Universiteti Islamik i Medinës

Kushtet e imanit

Grup autorësh

Hyrje

Kushtet e imanit janë: Besimi në Allahun, besimi në Melekët e Tij, besimi në Librat e Tij, besimi në të Dërguarit e Tij, besimi në Ditën e Fundit dhe besimi në Kaderin e Tij qoftë i mirë apo jo i mirë.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَلَكِنَّ الْبِرَّ مَنْ ءَامَنَ بِاللّٰهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَالْمَلَائِكَةِ وَالْكِتَابِ وَالنَّبِيِّينَ﴾ [YBB ﴿١٧٧﴾]

“...por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson Allahut, Ditës së Fundit, melekëve, librit, të Dërguarve...” (El Bekare 177).

اٰكُلٌ ءَامَنَ بِاللّٰهِ وَمَلَائِكَتِهٖ وَكُتُبِهٖ وَرُسُلِهٖ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ اٰحَدٍ مِّنْ رُّسُلِهٖ... ﴿١٧٧﴾ [YBB ﴿١٧٧﴾]

“...Secili i besoi All-llahut, engjëjve të Tij, shpalljeve të Tij, të Dërguarve të Tij. Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin nga të Dërguarit e Tij...” (El Bekare 258).

اِنَّا كُلَّ شَيْءٍ خَلَقْنَاهُ بِقَدَرٍ ﴿١٧٨﴾ [YBB ﴿١٧٨﴾]

“Ne çdo send e kemi krijuar me kader (caktim).” (El Kamer 49).

Thotë i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “Imani është të besosh Allahun, Melekët e Tij, librat e Tij, Ditën e Fundit dhe të besosh në Caktimin (Kaderin) qoftë i mirë apo jo i mirë” (Muslimi).

Imani është fjalë me gjuhë, bindje me zemër dhe veprim me gjymtyrë, shtohet me punë të mira dhe pakësohet me mëkate.

Allahu i Lartësuar thotë:

إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ الَّذِينَ إِذَا ذُكِرَ اللَّهُ وَجِلَتْ قُلُوبُهُمْ وَإِذَا تُلِيَتْ عَلَيْهِمْ آيَاتُهُ زَادَتْهُمْ إِيمَانًا وَعَلَىٰ رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ ﴿٢﴾ الَّذِينَ يُقِيمُونَ الصَّلَاةَ وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنْفِقُونَ ﴿٣﴾ أُولَٰئِكَ هُمُ الْمُؤْمِنُونَ حَقًّا لَهُمْ دَرَجَاتٌ عِنْدَ رَبِّهِمْ وَمَغْفِرَةٌ وَرِزْقٌ كَرِيمٌ ﴿٤﴾ ﴿٢٧﴾

“E, besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, të cilëve kur përmendet Allahu u rrënoqethen zemrat e tyre, kur u lexohen ajetet e Tij u shtohet besimi, dhe që janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre. Dhe, të cilët falin namazin dhe nga ajo, me çka Ne i furnizuar, ata japin. Të tillët janë besimtarë të vërtetë dhe për këtë kanë vende të larta te Zoti i tyre, kanë falje dhe kanë furnizim në mënyrë të ndershme.” (El Enfal 2-4).

وَمَنْ يَكْفُرْ بِاللَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ وَكُتُبِهِ وَرُسُلِهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ فَقَدْ ضَلَّ ضَلَالًا بَعِيدًا ﴿٢٨﴾ ﴿٢٨﴾

“...Kush nuk i beson Allahut, engjëjve të Tij, librave të Tij, të dëguarve të Tij dhe ditës së fundit, ai ka humbur tepër larg.” (En Nisa’ 136).

Imani mundet me qenë me gjuhë, p.sh. Përkujtimi i Zotit (dhikri), lutja (dua), urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja, leximi i Kur’anit e të ngjashme. Mundet me qenë edhe me zemër, p.sh. Bindja në Njësinë e Allahut në Zotërim, në Adhurim, në Emrat e Cilësitë e Tij dhe në obligimin e adhurimit të Allahut Një e të pa shoq dhe gjithë çka hyn në të qoftë nijet apo qëllim.

Në përkufizimin e besimit hyjnë edhe punët e zemrës, siç janë: Të dashurit e Allahut, frika e shpresa ndaj Zotit, mbështetja në Të (tevekkuli) e të ngjashme. E hyjnë në këtë përkufizim edhe veprat e gjymtyrëve, siç janë: Namazi, agjërimi dhe kushtet tjera të Islamit¹, Lufta² në Rrugën e Allahut, kërkimi i dijes e të ngjashme.

Allahu i Lartësuar thotë:

اِذَا تُلِيَتْ عَلَيْهِمْ وَايَاتُهُ زَادَتْهُمْ اِيْمَانًا ﴿٢﴾ [Fet-h 2].

“...kur u lexohen ajetet e Tij u shtohet besimi...” (El Enfal 2).

هُوَ الَّذِي أَنْزَلَ السَّكِينَةَ فِي قُلُوبِ الْمُؤْمِنِينَ لِيَزْدَادُوا اِيْمَانًا مَعَ اِيْمَانِهِمْ ﴿٢٥﴾ [Fet-h 4].

“Ai është që në zemrat e besimtarëve dhuroi qetësinë për ta shtuar ata bindjen në besimin e vet që kishin.” (El Fet-h 4).

Imani shtohet sa herë që shtohen veprat e mira të robit dhe ato me të cilat i afrohet Zotit dhe pakësohet sa herë që pakësohen veprat e mira të tij dhe ato me të cilat i afrohet Zotit. Gjithashtu ndikojnë edhe mëkatet: Nëse mëkati është shirk i madh, apo kufër i madh, atëherë zhvlerësohet esenca e besimit të ligjshëm dhe e ka prishur besimin, e nëse mëkati është diç tjetër nga këto, atëherë zhvlerësohet përsosmëria e tij e obliguar, njolloset pastërtia e tij dhe dobësohet.

¹ Zekati dhe Haxhi.

² Përpjekja apo xhihadi.

Allahu i Lartësuar thotë:

اِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ اَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ...

﴿[44]﴾.

“S’ka dyshim se Allahu nuk falë (mëkatin) t’i përshkruhet Atij shok (shirkun e madh), e përpos këtij (mëkati) i falë kujt do...” (En Nisa’ 48).

اِیْحَلِفُوْنَ بِاللّٰهِ مَا قَالُوْا وَلَقَدْ قَالُوْا کَلِمَةً الْکُفْرِ وَکَفَرُوْا بَعْدَ

اِسْلَامِهِمْ... ﴿[34]﴾.

“Ata betohen në Allahun se nuk kanë thënë (asgjë të keqe), e në të vërtetë, kanë thënë fjalë të kufrit, dhe mohuan pas besimit të tyre” (Et Teube 74).

Thotë i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “Nuk është besimtar laviri gjatë laviritetit të tij, e as hajni nuk është besimtar gjatë hajnisë, e nuk është besimtar as ai që pin verë gjatë pirjes së saj” (Buhariu dhe Muslimi).

Kushti i parë: Besimi në Allahun e Lartësuar

1.Realizimi i këtij besimi

Realizohet besimi në Allahun e Lartësuar me këto që vijnë:

E para- Bindja se kjo kreaturë e ka Një Zot të Vetëm, që Vetëm Ai e krijoi, e zotëron dhe e udhëheqë, i ndryshon çështjet e saj, me furnizim, me fuqi e me vepër, duke e gjallëruar dhe duke e vdekur, duke i bërë dobi dhe duke e dëmtuar. Zot që nuk ka tjetër pos Tij, bën Vet ç'të dojë dhe gjykon si të dojë, e lartëson kënd të dojë dhe e poshtëron kënd të dojë, në dorë të Tij është mbretërimi i qiejve dhe tokës e që është i Gjithfuqishëm mbi çdo gjë, që di çdo gjë, i panevojshëm për ndokënd. E gjithë çështja është në dëshirën e Tij, e gjithë e mira është në dorën e Tij, nuk ka shoq në punët e Tij, e as mbizotërues mbi të në çështjet e Tij. Përkundrazi, e gjithë kreatura, qofshin melekët, njerëzit apo xhinët janë robër të tij, që nuk dalin nga zotërimi i Tij, fuqia e Tij e as nga dëshira e Tij, qoftë i Lartësuar. Punët e tij nuk janë të kufizuara, e as nuk kufizohen me numër, e të gjitha këto specifika janë të vërteta vetëm për Të të Vetmin e të pa shoq, e nuk i meriton ato askush pos Tij dhe nuk lejohet përshkruarja dhe vërtetimi i ndonjëres prej tyre për dikë tjetër pos Allahut të Lartësuar.

Thotë Allahu i Lartësuar:

اِیَّاهَا النَّاسُ اَعْبُدُوا رَبَّکُمْ الَّذِیْ خَلَقَکُمْ وَالَّذِیْنَ مِنْ قَبْلِکُمْ
لَعَلَّکُمْ تَتَّقُوْنَ ﴿٢٠﴾ الَّذِیْ جَعَلَ لَکُمُ الْاَرْضَ فِرَاشًا وَالسَّمَآءَ بَنَآءً

وَأَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الثَّمَرَاتِ رِزْقًا لَّكُمْ ... ﴿٢١﴾

“O njerëz, adhurojeni Zotin tuaj, i cili ju krijoi juve edhe ata që ishin para jush ashtu që të jeni të devotshëm. Ai, i cili për ju bëri tokën shtrat (vendbanim), e qiellin kulm, e prej qiellit ju lëshoi shi me të cilin ju siguroi lloje të frutave si ushqim për ju...” (El Bekare 21-22).

١ قُلِ اللَّهُمَّ مَلِكُ الْمَلِكِ تُؤْتِي الْمَلِكَ مَن تَشَاءُ وَتَنْزِعُ الْمَلِكَ مِمَّن تَشَاءُ وَتُعِزُّ مَن تَشَاءُ وَتُذِلُّ مَن تَشَاءُ بِيَدِكَ الْخَيْرُ إِنَّكَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٢٢﴾

“Thuaj: “O Allah, Sundues i çdo sendi, Ti ia jep pushtetin atij që do, Ti ia heq prej dore pushtetin atij që do dhe e përul atë që do, e lartson atë që do. Çdo e mirë është në dorën Tënde, vërtet, Ti ke mundësi për çdo gjë!”” (Ali Imran 26).

١ وَمَا مِن دَابَّةٍ فِي الْأَرْضِ إِلَّا عَلَى اللَّهِ رِزْقُهَا وَيَعْلَمُ مُسْتَقَرَّهَا وَمُسْتَوْدَعَهَا كُلٌّ فِي كِتَابٍ مُّبِينٍ ﴿٢٣﴾

“Nuk ka asnjë gjallesë në tokë që Allahu të mos ketë garantuar furnizimin e saj, Ai e di vendbanimin dhe vendstrehimin e saj (pas vdekjes). Të gjitha (këto) janë në librin e qartë (Levhi Mahfudhë)” (Hudë 6).

١ ... أَلَا لَهُ الْخَلْقُ وَالْأَمْرُ تَبَارَكَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ ﴿٢٤﴾

“...Ja, vetëm Atij i takon krijimi dhe sundimi. I madhëruar është Allahu, Zoti i botëve” (El A’raf 54).

E dyta- Bindja se Allahu i Lartësuar veçohet me Emrat më të bukur dhe Cilësitë me të plota, disa prej të cilave ia njoftoi robëve në Librin e Tij apo në Sunnetin e të Dërguarit të fundit të Tij, Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Thotë Allahu, qoftë i Lartësuar:

اِنَّ لِلّٰهِ الْاَسْمَاءَ الْحُسْنٰى فَادْعُوْهُ بِهَا وَذَرُوْا الَّذِيْنَ يُلْحِدُوْنَ فِيْهِ

اَسْمَآئِهِۦ سَيُجْزَوْنَ مَا كَانُوْا يَعْمَلُوْنَ ﴿١٨﴾ ﴿١٧﴾

.[YyT

“Allahu ka Emrat më të mirë, andaj Atë thirrnie me ata e hiquni nga ata që bëjnë shtrembërime me emrat e Tij. Ata kanë për t’u dënuar për veprimet e tyre” (El A’raf 180). Thotë i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “Me të vërtetë Allahu ka 99 emra e kush i mëson (i vërteton dhe përfiton nga përmbajtja e tyre), do të hyjë në Xhennet. Ai është Tek dhe e don tekun” (Buhariu dhe Muslimi).

Kjo bindje është e ndërtuar mbi dy themele të mëdha:

1.Allahu ka Emra të bukur dhe Cilësi të përsosura që argumentojnë cilësi të përsosura e jo të mangëta nga asnjë pikvështrim. Nuk i përgjason dhe nuk e shoqëron në to asgjë dhe asnjëra nga krijesat.

Nga Emrat e Tij, qoftë i Lartësuar, është El Hajju (I Gjalli) dhe Ai e ka cilësinë e Gjallërisë, e cila obligohet t’i vërtetohet Atij, i Lartësuar qoftë, në mënyrë të përsosur ashtu si i takon Atij, e kjo gjallëri është Gjallëri e plotë dhe e gjithmonshme, janë përmbledhur në të lloje të shumta të përsosmërive siç janë Dija, Fuqia e të ngjashme, gjallëri që nuk është e paraprirë prej jogjallërisë, gjallëri që nuk i nënshtrohet fundit. Thotë i Lartësuari:

اَللّٰهُ لَا اِلٰهَ اِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّوْمُ لَا تَاْخُذُهٗ سِنَةٌ وَّلَا نَوْمٌ ... ﴿١٠٢﴾

“Allahu. Nuk meriton të adhurohet dikush pos Tij. I Gjalli, Vigjiluesi. Nuk e ze të koturit, e as gjumi...” (El Bekare 255).

2.Allahu i Lartësuar absolutisht është i zhveshur nga cilësitë e mangëta e të metat, siç janë gjumi, paaftësia, mosdija, padrejtësia e të ngjashme, ashtu siç është i zhveshur nga përgjasimi me krijesat. Pra, obligohet mohimi i asaj që e ka mohuar Allahu për veten e Tij dhe që e ka mohuar i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem për Zotin e Tij. Gjithë kësaj i shtohet bindja se Allahu është i cilësuar me përsosmëri, të kundërtën e atyre që i mohohen Atij, e nëse e ia mohojmë Atij të koturit, me këtë e vërtetojmë Vigjëlimin e përsosur të Tij, e nëse ia mohojmë gjumin, e vërtetojmë Gjallërinë e Tij të përsosur. Kështu pra, çdo mohim i diqkafit për Allahun e Lartësuar, përmban në vete vërtetimin e të përsosurës, të kundërtës së tij, e Ai është i Përsosur e çdo gjë pos Tij është e mangët. Thotë i Lartësuari:

... لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ ﴿١١٢﴾

“...Asnjë send nuk është si Ai; Ai është Dëgjuesi, Shikuesi” (Esh shura 11).

... وَمَا رَبُّكَ بِظَلَّامٍ لِّلْعَبِيدِ ﴿٤٦﴾

“...e Zoti yt nuk u bën padrejtësi robërve” (Fussilet 46).

ا ... وَمَا كَانَ اللَّهُ لِيُعْجِزَهُ مِنْ شَيْءٍ فِي السَّمَوَاتِ وَلَا فِي الْأَرْضِ ... ﴿١٧٧﴾

“Allahu nuk është i tillë që ndonjë send në qiej apo në tokë të mund ta bëjë të paaftë Atë” (Fatir 44).

ا ... وَمَا كَانَ رَبُّكَ نَسِيًّا ﴿٦٤﴾

“...e Zoti yt nuk është që harron” (Merjem 64).

Besimi në Emrat, Cilësitë dhe Punët e Tij është rruga e vetme për njohjen e Allahut dhe adhurimin e Tij. Kjo është sepse Allahu e pamundësoi për robët e Tij në këtë botë që ta shohin me sy, por e hapi këtë portë të dijes, që përmes saj e njohin Zotëruesin dhe të Adhuruarin e tyre dhe e adhurojnë në përputhje me këtë njohje të vërtetë dhe të shëndoshë. Adhuruesi e adhuron atë që e cilëson, falsifikuesi³ e adhuron atë që nuk ekziston, përgjasuesi⁴ e adhuron idhullin, e myslimani e adhuron Allahun e Vetëm, që nuk e ka lindur dikë, e as që është i lindur, e që askush nuk është i barabartë me Të.

Duhet t'i kemi parasysh te vërtetimi i Emrave të bukur të Allahut çështjet vijuese:

1.Besimi në vërtetimin e të gjithë Emrave të bukur, të përmendura në Kur'an dhe Sunnet, pa bërë ndonjë shtesë në to apo mangësim.

Thotë Allahu i Lartësuar:

³ Ai që i shtrembëron kuptimet e ajeteve dhe haditheve e sidomos atyre që kanë të bëjnë me Emrat dhe Cilësitë e Allahut quhet Falsifikues (Muattil).

⁴ Përgjasues është ai person që i përgjason Cilësitë e Allahut me ato të krijesave

ا هُوَ اللّٰهُ الَّذِي لَا اِلٰهَ اِلَّا هُوَ الْمَلِكُ الْقُدُّوسُ السَّلَامُ الْمُؤْمِنُ
 الْمُهِيمُ الْعَزِيزُ الْجَبَّارُ الْمُتَكَبِّرُ سُبْحَانَ اللَّهِ عَمَّا
 يُشْرِكُونَ ﴿٢٣﴾

“Ai është Allahu që nuk ka zot tjetër përveç Tij, sundues i përgjithshëm, i pastër, shpëtimtar, siguries, mbikëqyrës, i plotfuqishëm, mbizotërues, i madhërishëm. I lartësuar është Allahu nga çka i shoqërojnë” (El Hashër 23). Është vërtetuar me Sunnet, se i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem e ka dëgjuar një njeri duke thënë: “O Zoti im, unë po kërkoj prej Teje, se Ti je Ai që të takon falënderimi, nuk meriton kush adhurim pos Teje, Gjithbëmirës, Shpikës i qiejve dhe tokës, o Zotërues i Madhështisë dhe Nderimit të pa kufi, o I Gjallë dhe Vigjëlues”. Tha i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “A e dini se me çka e luti Allahun?” I thanë: Allahu dhe i Dërguari i Tij e din më së miri! Tha: “Pasha Atë që shpirti im është në dorën e Tij, e ka lutur Allahun me Emrin e Tij më të madh, Emër me të cilin nëse lutet me të, përgjigjet, e nëse i kërkohet diçka, jep ” (Ebu Davudi dhe Ahmedi).

2.Besimi se Allahu është Ai i Cili e emërtoi Vetën e Tij, e nuk emërtohet prej dikujt nga robërit, e Ai, i madhëruar qoftë, është që e lavdëroi Vetën me këto Emra, e nuk janë emra të shpikur e të krijuar.

3.Besimi se Emrat e bukur të Allahut përmbajnë në vete domethënie shumë të përsosura, nuk ka mangësi në to nga asnjë pikvështrim, dhe obligohet besimi në këto kuptime, ashtu siç obligohet besimi në këto Emra.

4.Obligohet respektimi i kuptimeve të këtyre Emrave dhe moskundërshtimi i tyre qoftë me shtrëmbërimin e të vërtetës së tyre apo me mohimin e tyre.

5.Besimi në gjithë atë që e përmban secili Emër, duke filluar prej rregullave e mandej gjithë asaj që nënrenditet pas tyre: veprimeve dhe ndikimeve.

Për t'i qartësuar këto pesë çështje, do të sjellim një shembull për to me Emrin e Allahut, **Es Semi'u** (Dëgjuesi). Obligohemi për këtë Emër t'i kemi parasysh këto gjëra:

A) Besimi në vërtetimin e Emrit “Dëgjuesi”, si një nga Emrat e Bukur të Allahut, se është i përmendur në Kur'an dhe Sunnet.

B) Besimi se Allahu është Ai i Cili e emërtoi Vetën me këtë Emër, ka folur për të dhe e ka zbritur në Librin e Tij madhështor.

C) Besimi se “Dëgjuesi”, argumenton “dëgjimin”, e ky është një nga Cilësitë e Tij.

Ç) Obligimi i respektimit të Cilësisë së dëgjimit për të cilën na argumentoi Emri “Dëgjuesi” dhe ndalimi i shtrembërimit të kuptimit të vërtetë të saj apo mohimit të saj.

D) Besimi se Allahu dëgjon çdo gjë dhe se dëgjimi i Tij përfshin të gjithë zërat dhe besimi në ndikimin që nënrenditet pas këtij besimi e që është mbikëqyrja e Allahut, droja dhe frika ndaj Tij. Gjithashtu bindja e plotë në atë se Allahut, qoftë i Lartësuar, nuk i fshehet asgjë.

Duhet të kemi parasysh në vërtetimin e Cilësive të përsosura të Allahut me sa vijon:

1.Vërtetimin e të gjitha Cilësive të përmendura në Kur'an dhe Sunnet, për Allahun e Lartësuar, si të vërteta pa ndonjë shtrembërim apo mohim.

2.Besimi i prerë se Allahu i Lartësuar është i cilësuar me Cilësi të përsosura, i Pastër nga çdo cilësi e mangët.

3.Ndalimi i përgjasimit të Cilësive të Allahut me cilësitë e krijesave. Nuk është askush si Allahu i Madhëruar as në Cilësitë e Tij e as në Punët e Tij. Thotë i Lartësuar:

اَلَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ ﴿١٧٣﴾

.[YY: ﴿١٧٣﴾]

“...Asnjë send nuk është si Ai; Ai është Dëgjuesi, Shikuesi” (Esh shura 11).

4.Mosinteresimi i plotë për njohjen e formës së këtyre Cilësive, se nuk e di formën e Cilësisë së Allahut askush përveç Tij, pra, nuk ka mundësi që krijesa të arrijë te kjo njohje.

5.Besimi në atë që nënrenditet pas këtyre Cilësive, qofshin ato rregulla, apo ndikime që i përmbajnë, e çdo Cilësi përmban në vete adhurim.

Për t’i qartësuar këto pesë çështje, do ta sjellim një shembull për to, me Cilësinë e Allahut, **El Istiva’u**, “Qëndrimi mbi Arsh⁵”. Obligohemi për këtë Cilësi t’i kemi parasysh këto gjëra:

1.Vërtetimi i Cilësisë “Qëndrimi mbi Arsh” për Allahun e Madhëruar dhe besimin në të pasiqë është përmendur në argumentet e sheriatit. Thotë Allahu i Lartësuar:

اَلرَّحْمَنُ عَلَى الْعَرْشِ اسْتَوٰى ﴿٢٠﴾

“Mëshiruesi që qëndron mbi Arsh” (Ta Ha 5).

2.Vërtetimi i Cilësisë “Qëndrimi mbi Arsh” për Allahun e Madhëruar, në mënyrën më të përsosur ashtu si i takon Atij, qoftë i Lartësuar. Kuptimi i saj është Lartësimi dhe Ngritja e Allahut mbi Arshin e Tij realisht, ashtu si i takon Madhërisë së Tij.

⁵ Froni i Allahut xhel-le shanuhu

3.Ndalimi nga të përgjasuarit e qëndrimit të Krijuesit mbi Arsh, me qëndrimin e krijesave, duke e ditë se Allahu është i pavarur dhe nuk ka nevojë për Arshin, e qëndrimi i krijesave obligohet nga varësia dhe nevoja. Thotë Allahu i Lartësuar:

لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ ﴿١٧٧﴾
[YY: ﴿١٧٧﴾].

“...Asnjë send nuk është si Ai; Ai është Dëgjuesi, Shikuesi” (Esh Shura 11).

4.Ndalimi i detalizimit rreth mënyrës së qëndrimit të Krijuesit mbi Arsh, se kjo është çështje e fshehtë që nuk e din askush përveç Allahut azze ve xhel-le.

5.Besimi në dispozitën dhe ndikimin që nënrenditet, e që është vërtetimi i madhështisë së Allahut, Lartmadhërisë dhe Krenarisë që i takon Atij. E argumenton këtë Lartësia e Tij absolute, qoftë i madhëruar, mbi të gjithë kreaturën dhe animi i zemrave në këtë madhësi ashtu si thotë njeriu në sexhde: Subhane rabbijel a’la (I pastër nga çdo e metë është Zoti im i Lartësuar).

E treta-Besimi i robit se Allahu është Zoti i Vërtetë që meriton të veçohet në të gjitha adhurimet, qofshin ato të hapura apo të fshehta, duke mos i bërë shoq Atij.

Thotë i Lartësuari:

وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا أَنِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا
الطَّاغُوتَ ... ﴿١٧٨﴾
[Xa: ﴿١٧٨﴾].

“Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t’u thonë: “Adhuroni vetëm Allahun, e largonu tagutëve⁶...” (En Nahl 36). Gjithashtu çdo i dërguar i ka thënë popullit të vet:

⁶ Tagut: Çdo gjë tjetër e adhuruar pos Allahut. Gjithashtu Djalli, shejtanët, gurët, dielli, yjet, qeniët njerëzore, engjëjt, ikonat, varret, udhëheqësit, sistemet sunduese e

ا ... اَعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ مِنْ إِلَهٍ غَيْرُهُ ... ﴿٥٩﴾
[٥٩].

“...adhuronie Allahun, nuk keni zot tjetër pos Tij...” (El A’raf 59).

ا وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ حُنَفَاءَ ... ﴿٦٠﴾
[٦٠].

“E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të singertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë...” (El Bejjine 5).

Në të dy Sahihet⁷ transmetohet se i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem i ka thënë Muadhit: “A e di se cila është e drejta e Allahut ndaj robëve dhe cila është e drejta e robëve ndaj Allahut”. Thashë⁸: Allahu dhe i Dërguari i Tij e dijnë më së miri. Tha: “E drejta e Allahut ndaj robëve është që ta adhurojnë Atë pa i shoqëruar askend në adhurim, e e drejta e robëve ndaj Allahut është që mos ta dënojnë askend që nuk i ka bërë shoq në adhurimin e Tij”.

Zoti i Vërtetë është Ai që zemrat drejtohen drejt Tij dhe mbushen me dashuri ndaj Tij pa pasur nevojë për dashuri ndaj dikujt tjetër, mjaftohen me shpresën në Të pa shpresuar nga dikush tjetër. Janë të pavarur nga dikush tjetër, në lutje e kërkim të ndihmës prej Tij, në frikë e drojë ndaj Tij.

Thotë Allahu i Lartësuar:

të ngjashme me to kur adhurohen, merren si tagutë. Tagut ka edhe kuptimin e gjykatësit të remë.

⁷ Librat e Buhariut dhe Muslimit, me përmbledhje të haditheve të sakta.

⁸ Këtu flet Muadhi.

ا ذَالِكَ بِأَنَّ اللَّهَ هُوَ الْحَقُّ وَأَنَّ مَا يَدْعُونَ مِنْ دُونِهِ هُوَ

الْبَاطِلُ وَأَنَّ اللَّهَ هُوَ الْعَلِيُّ الْكَبِيرُ ﴿١٢﴾ ﴿١١﴾

“Kjo ngase Allahu është Ai i vërteti, dhe atë që lusin ata pos Tij është e kotë. Allahu është vërtetë Ai i larti, i madhi” (El Haxh 62).

Ky është pra Tevhidi (Njësimi) i Allahut në veprat e robëve. E rëndësia e tevhidit sillet në pikat vijuese:

1. Është filli i fesë, qëllimi i saj, mbarimi i saj, e dukshmja dhe e fshehta e saj, është thirrja e të gjithë të Dërguarve alejhimus selam.

2. Për shkak të këtij tevhidi Allahu e krijoi kreaturën, i dërgoi të Dërguarit e i zbriti librat, e gjithashtu për shkak të tij krijesat ranë në mospajtim dhe u ndanë në besimtarë dhe qafirë, në të lumtur dhe në të dëshpruar.

3. Është obligimi i parë për çdo të moshëritur myslimanë dhe është çështja e parë me të cilën hyn njeriu në Islam dhe e fundit me çka del nga kjo botë.

Realizimi i Tevhidit: Është zhveshja dhe pastrimi i tij nga të gjitha njollat e shirkut, bidatit⁹ dhe mëkateve. Ndahet në dy grupe: I obliguar dhe i preferuar.

Realizimi i obliguar përbëhet nga tri gjëra:

1. Zhveshja e tij nga shirku që e zhvlerëson esencën e tevhidit.

2. Zhveshja e tij nga bidatet të cilat e zhvlerësojnë përsosmërinë e obliguar të tij, apo e zhvlerësojnë esencën e tij nëse janë nga bidatet që të shpiejnë në kufër.

3. Zhveshja e tij nga mëkatet të cilat mangësojnë shpërblimin e tij dhe ndikojnë keq në të.

Ndërsa realizimi i preferuar shpjegohet me shembujt e mëposhtëm:

⁹ Bidat është risi në fe.

A.Realizimi i përsosur i Ihsanit¹⁰.

B.Realizimi i përsosur i bindjes.

C.Realizimi i përsosur i durimit të mirë, duke mos u ankuar te dikush tjetër pos Allahut të Lartësuar.

Ç.Realizimi i përsosur i lutjes së Allahut, duke u pavarësuar nga krijesat e Tij.

D.Realizimi i përsosur i mbështetjes (tevekulit), duke i lënë disa nga punët e lejuara siç janë kërkimi i rukjes¹¹ dhe iktivaja¹², duke u mbështetur në Allahun e Lartësuar.

Dh.Realizimi i përsosur i dashurisë (ndaj Allahut), duke iu afruar Allahut të Lartësuar me adhurime vullnetare (nafile).

Ai i cili e realizon tevhidin në mënyrën që e përmendëm dhe shpëton nga shirku i madh, sigurohet nga qëndrimi i gjithmonshëm në Zjarr, e ai që shpëton nga shirku i madh e i vogël, e largohet nga mëkatet e mëdha, sigurohet plotësisht në këtë dhe në botën tjetër.

Allahu i Lartësuar:

اِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ اَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ ...

[١٧:٤٠] ﴿وَمَا يَغْفِرُ اَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ...﴾

“S’ka dyshim se Allahu nuk falë (mëkatin) t’i përshkruhet Atij shok (shirkun), e përpos këtij (mëkati) i falë kujt do...” (En Nisa’ 48).

اَلَّذِينَ ءَامَنُوا وَلَمْ يَلْبِسُوْا اِيْمَنَهُمْ بِظُلْمٍ اُولٰٓئِكَ لَهُمُ الْاَمْنُ

وَهُمْ مُّهْتَدُونَ ﴿١٧٠﴾

¹⁰ Ihsani është ta adhurosh Allahun sikur je duke e parë Atë.

¹¹ Rukje: Të shëruarit me anë të leximit të Kur’anit.

¹² Lloj mjekimi i kohës së mesjetës, që bëhet me gjilpërë të nxehtë.

“Ata që besuan dhe besimin e tyre nuk e ngatërruan me besim të kotë, atyre u takon të jenë të sigurt dhe ata janë në rrugë të drejtë” (El En’am 82).

I kundërt me tevhidin është shirku, me tri llojet e tij:

1. Shirku i madh që e zhvlerëson esencën e tevhidit, e Allahu nuk e fal këtë veçse me pendim, e ai që vdes me këtë mëkat do të jetë përgjithmonë në xhehenem. Ky shirk është t’i shoqërojë robi Zotit të vet dikë tjetër në adhurim, ta lusë Atë ashtu si e lut Allahun, e ka për qëllim atë, mbështetet në të, shpreson në të, e don atë, i frigohet atij, ashtu si e don Allahun dhe ashtu si i frigohet Atij.

Thotë Allahu i Lartësuar:

اِنَّهُ مَن يُشْرِكْ بِاللّٰهِ فَقَدْ حَرَّمَ اللّٰهُ عَلَيْهِ الْجَنَّةَ وَمَا وُجِهَ النَّارُ

وَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ أَنْصَارٍ ﴿٧٢﴾

“...ai që i përshkruan Zotit shok, Allahu ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) atij Xhennetin dhe vendi i tij është Zjarri. Për mizorët nuk ka ndihmës” (El Maide 72).

2. Shirku i vogël që e zhvlerëson përsosmërinë e tevhidit, është çdo mjet i cili të qon drejt shirkut të madh. P.sh. betimi në dikend tjetër pos Allahut dhe syfaqësia.

3. Shirku i fshehtë, që lidhet me qëllimet dhe nijetet. Mundet me qenë shirk i madh e mundet me qenë i vogël, ashtu siç u sqarua më lartë.

Transmetohet nga Mahmud ibën Lebid radijall-llahu anhu se i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “Ajo që më së shumti frigohem për juve është shirku i vogël”. E pyetën: Çka është shirku i vogël o i Dërguar i Allahut. Tha: “Syfaqësia” (Ahmedi).

2.Definicioni i Ibadetit (adhurimit)

Ibadeti (adhurimi) është term gjithpërmbledhës për çdo gjë që e don Allahu dhe është i kënaqur me të, si bindjet, punët e zemrës dhe punët e gjymtyrëve dhe çdo gjë e cila të afron te Allahu, qoftë punë apo lënie (e punës së keqe).

Hyn gjithashtu në përkufizimin e ibadetit çdo gjë që e ka ligjësuar Allahu në Librin e Tij apo në Sunnetin e të Dërguarit të Tij Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sellem. Bëjnë pjesë këtu adhurimet e llojllojshme. Ka prej tyre adhurime të zemrës siç janë gjashtë kushtet e imanit, frika, shpresa, mbështetja, shpresa në mëshirë, frika nga ndëshkimi e ibadete tjera. Ka prej tyre edhe adhurime të dukshme siç janë namazi, zekati, agjërimi dhe haxhi.

Ibadeti (adhurimi) nuk është i vlefshëm derisa të ndërtohet në dy themele:

I pari është sinqeriteti në adhurimin e Allahut dhe mosshoqërimi i dikujt tjetër në adhurim, e ky është kuptimi i dëshmisë La ilahe il-lall-llah (Nuk meriton kush adhurim pos Allahut). Thotë i Lartësuari:

أَلَا لِلَّهِ الدِّينُ الْخَالِصُ وَالَّذِينَ اتَّخَذُوا مِنْ دُونِهِ
أَوْلِيَاءَ مَا نَعْبُدُهُمْ إِلَّا لِيُقَرِّبُونَا إِلَى اللَّهِ زُلْفَىٰ إِنَّ اللَّهَ يَحْكُمُ
بَيْنَهُمْ فِي مَا هُمْ فِيهِ يَخْتَلِفُونَ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي مَنْ هُوَ كَاذِبٌ كَفَّارٌ

[X: ﴿٢٥﴾]

“Vini re! Adhurim i sinqertë është vetëm ai për Allahun! Ndërsa ata që në vend të Tij adhurojnë miq të tjerë (duke thënë): Ne nuk i adhurojmë ata për tjetër, vetëm që të na afrojnë sa më afër Allahut, s’ka dyshim se

Allahu do të gjykojë mes tyre për atë që ata ishin në kundërshtim. E, është e vërtetë se Allahu nuk udhëzon në rrugë të drejtë, atë që është rrenacak, jobesimtar” (Ez Zumer 3).

ا وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ حُنَفَاءَ ... ﴿٣٠﴾
 .[Ω<✱h>Ω]

“Ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të singertë ndaj Tij...” (El Bejjineh 5).

I dyti është pasimi i asaj me të cilën ka ardhë i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Pra, që të veprojë rob i atë që e ka vepruar i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në mënyrën se si e veproi ai pa ndonjë shtesë e as mangësim. E ky është kuptimi i dëshmisë Muhammedun resulull-llah (Nuk meriton kush pasim pos Muhammedit të Dërguarit të Zotit).

Thotë Allahu, qoftë i Lartësuar:

ا قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ ... ﴿٣١﴾
 .[XY:<✱h>Ω]

“Thuaj: Nëse e doni Allahun, atëherë ejani pas meje që Allahu të ju dojë, t’ju falë mëkatet tuaja...” (Ali Imran 31).

ا ... وَمَا وَاتِلَكُمْ الرَّسُولُ فَاخْذُوهُ وَمَا نَهَاكُمْ عَنْهُ فَانْتَهُوا ... ﴿٣٢﴾
 .[β:<✱h>Ω]

“...Çka t’ju jep Pejgamberi, atë merrnie e çka t’ju ndalojë, përmbanju...” (El Hashr 7).

ا فَلَا وَرَبِّكَ لَا يُؤْمِنُونَ حَتَّىٰ يُحَكِّمُوكَ فِيمَا شَجَرَ بَيْنَهُمْ
 ثُمَّ لَا يَجِدُوا فِيْٓ اَنْفُسِهِمْ حَرَجًا مِّمَّا قَضَيْتَ وَيُسَلِّمُوْا تَسْلِيْمًا ﴿٦٥﴾
 .[﴿٦٥﴾]

“Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë derisa të mos zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden singerisht” (En Nisa’ 65).

Të adhuruarit e plotë nuk realizohet pa këto dy çështje:

E para: Përsosmëria e dashurisë ndaj Allahut, ashtuqë robi i jep përparësi dashurisë ndaj Allahut dhe dashurisë ndaj atyre që i don Allahu, para dashurisë ndaj çdo gjëje tjetër.

E dyta: Përsosmëria e nënshtrueshmërisë dhe e përluljes ndaj Allahut, ashtuqë robi i nënshtrohet Allahut duke i kryer urdhërat e Tij dhe duke u larguar nga ato që i ka ndaluar Ai.

Pra, të adhuruarit është shprehje që përmbledh përsosmërinë e dashurisë dhe përsosmërinë e nënshtrimit, përluljes, shpresës dhe frikës. Me këtë realizohet të adhuruarit e robit ndaj Zotit dhe Krijuesit të Vet. Duke e adhuruar Allahun robi arrin te dashuria e Allahut dhe kënaqësia e Tij. Allahu dëshiron që robi i Tij t’i afrohet me ato që ia bëri obligim. E sa më shumë që robi i shton ibadetet vullnetare (nafilet), shtohet afria e tij ndaj Allahut azze ve xhel-le dhe ngritet shkalla e tij tek Allahu. Kjo bëhet shkak prej shkaqeve të hyrjes në Xhennet me mirësinë e Allahut dhe me mëshirën e Tij. Thotë Allahu subhanehu ve teala:

اَدْعُوا رَبَّكُمْ تَضَرُّعًا وَخُفْيَةً اِنَّهٗ لَا يُحِبُّ الْمُعْتَدِينَ ﴿٥٥﴾
 .[Mashhad]

“Lutnie Zotin tuaj të përrulur e në heshtje, pse Ai nuk i do ata që e teprojnë” (El A’raf 55).

3.Argumentet e Tevhidit (Njësisë) së Allahut

Argumentet që dëshmojnë Njësinë e Allahut janë të shumta, e ai që përsiatë në to dhe i studion me mendjen e tij, pajiset me dituri dhe i shtohet bindja e tij në Veçimin e Zotit subhanehu ve teala, në Njësimin e Tij në Veprat, Emrat, Cilësitë dhe në të adhuruarit e Tij.

Po sjellim si shembuj disa nga këto argumente:

A.Madhështia e krijimit të kësaj ekzistence, preciziteti i ndërtimit të saj dhe llojllojshmëria e krijesave të saja, sistemi preciz në të cilin ecën. Ai i cili përsiatë dhe mendon në këto, bindet në Njësinë e Allahut. Ai i cili përsiatë në krijimin e qiejve dhe tokës, krijimin e diellit dhe të hënës, krijimin e njeriut dhe kafshëve, krijimin e bimëve dhe gjërave të ngurta, bindet se këto kanë Një Krijues të Përsosur në Emrat e Cilësitë e Tij, në të adhuruarit e Tij, e këto argumentojnë se Ai është Një, i Vetmi që meriton adhurimin.

Thotë Allahu, i Lartësuar qoftë:

اَوَجَعَلْنَا فِي الْاَرْضِ رَوَاسِيْۢمَۢمَۢاۤ اَنْ تَمِيْدَ بِهِمْ وَجَعَلْنَا فِيْهَا فِجَاجًا سُبُلًا لَّعَلَّهُمْ يَهْتَدُوْنَ ﴿٦٠﴾ وَجَعَلْنَا السَّمٰوٰتِ سَقْفًا مَّحْفُوْظًا وَهُمْ عَنْ

وَإِيَّاهَا مُعْرِضُونَ ﴿٣٢﴾ وَهُوَ الَّذِي خَلَقَ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ وَالشَّمْسَ
وَالْقَمَرَ كُلٌّ فِي فَلَكٍ يَسْبَحُونَ ﴿٣٣﴾ ﴿٣٢﴾ -XY: ﴿٣٣﴾
[XX].

“Dhe në të (tokë) Ne kemi krijuar bjeshkë të paluhatshme që të mos i lëkundë ata, dhe nëpër to kemi bërë luginat e rrugë në mënyrë që ata të dinë të orientohen. Qiellin ua kemi bërë kulm të sigurt, por ata zbrapsen prej atyre argumenteve. Ai është që krijoi natën e ditën, diellin e hënën dhe secili prej tyre noton në orbitë” (El Enbija 31-33).

۱ وَمِنْ وَآيَاتِهِ خَلَقُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاخْتَلَفُ السِّنِّكُمْ
وَالْوَنُكُمُ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّلْعَالَمِينَ ﴿٣٣﴾ ﴿٣٣﴾
[XX].

“Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve e i tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja. Edhe në këtë ka argumente për botët” (Er Rum 22).

B.Ajo me të cilën Allahu i dërgoi të Dërguarit, siç janë ligjet, dhe i forcoi ata me shenja e argumente që dëshmojnë Njësinë e Tij dhe Veçimin e Tij azze ve xhel-le në adhurim. E gjithë ajo që e bëri ligj Allahu për krijesat e Tij është argument i qartë se këto rregulla nuk burojnë nga askush pos Zotit të Urtë e të Ditur për krijesat e Tij, që e di se çka ju përshtatet (prej ligjeve) krijesave të tij. Thotë Allahu xhel-le shanuhu:

۱ لَقَدْ أَرْسَلْنَا رُسُلَنَا بِالْبَيِّنَاتِ وَأَنزَلْنَا مَعَهُمُ الْكِتَابَ وَالْمِيزَانَ
لِيَقُومَ النَّاسُ بِالْقِسْطِ ... ﴿٣٤﴾ ﴿٣٤﴾
[XX].

“Ne i dërguam të Dërguarit Tonë me dokumente të qarta dhe Ne zbritëm me ata librin dhe drejtësinë që t'i përmbahen njerëzit të së drejtës...” (El Hadid 25).

ا قُلْ لِّسِنِ اجْتَمَعَتِ الْاِنْسُ وَالْجِنُّ عَلٰى اَنْ يَّاتُوْا بِمِثْلِ هٰذَا
الْقُرْاٰنِ لَا يَّاتُوْنَ بِمِثْلِهٖ وَلَوْ كَانَتْ بَعْضُهُمْ لِبَعْضٍ ظَهِيرا ﴿٢٥﴾
[yy: ﴿٢٥﴾]

“Thua: “Edhe sikur të bashkoheshin njerëzit dhe xhinët për të sjellë një Kur'an të tillë, ata nuk do të mund të bënin si ky sado që do ta ndihmonin njëri - tjetrin”” (El Isra 88).

C.Natyrshmëria (fitreja) të cilën e mbolli Allahu në zemrat e robëve rezulton në pranimin e Njesisë së Allahut. Kjo është çështje e vendosur thellë në shpirtëra. Derisa ta goditë njeriun ndonjë dëm e gjen këtë natyrshmëri dhe i kthehet Allahut, e nëse njeriu shpëton nga dyshimet, e dyshimet janë ato që ia ndërrojnë natyrshmërinë e tij, nuk do të kishte gjetur kënaqësi shpirtërore, veçse pranimin dhe nënshtrimin para Veçimit të Allahut në adhurim, në Emrat, Cilësitë e Veprat e Tij dhe nënshtrimin ndaj ligjit të Tij, me të cilin i dërgoi të Dërguarit e Tij, paqja e shpëtimit qofshin mbi ta. Thotë Allahu i Lartësuar:

ا فَاَقِمَّ وَجْهَكَ لِلدِّينِ حَنِيفًا فِطْرَتَ اللّٰهِ الَّتِي فَطَرَ النَّاسَ عَلَيْهَا
لَا تَبْدِيلَ لِخَلْقِ اللّٰهِ ذٰلِكَ الدِّينُ الْقَيِّمُ وَلٰكِنَّ اَكْثَرَ النَّاسِ لَا
يَعْلَمُوْنَ ﴿٢٠﴾ * مُنِيْبِيْنَ اِلَيْهِ وَاتَّقُوْهُ وَاَقِيْمُوا الصَّلٰوةَ وَلَا تَكُوْنُوْا
مِّنَ الْمُشْرِكِيْنَ ﴿٢١﴾ [XY LXT: ﴿٢١﴾]

“Përqendro vetëveten tënde singerisht në fenë, i larguar prej çdo të kote, (e ajo fé është), natyrshmëria e Allahut në të cilën i krijoi njerëzit, s’ka ndryshim (mos ndryshoni) të asaj natyrshmërie të krijuar nga Allahu, ajo është feja e drejtë por shumica e njerëzve nuk e dinë, (përqëndrohuni në atë) Të kthyer singerisht tek Ai, kini frikë prej Tij, falnie namazin e mos u bëni nga idhujtarët” (Er Rum 31-31).

Thotë i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem:

“Çdo foshnjë lind me natyrshmërinë (që e ka mbjellur Allahu), e prindërit e tij e jehudizojnë apo e kristianizojnë apo e mexhusizojnë¹³,..., e mandej lexoi (ajetin): “natyrshmëria e Allahut në të cilën i krijoi njerëzit” (Buhariu).

¹³ E bëjnë mexhusi. Mexhusi ju thuhet adhuruesve të zjarrit.

Kushti i dytë: Besimi në melekë

1.Definicioni

Besimi në melekë (engjëj) është bindje e prerë se Allahu ka melekë që i ka krijuar nga drita, të krijuar për ta respektuar Atë, nuk i shkelin urdhërat e Allahut dhe veprojnë ashtu siç urdhërohen, e madhërojnë Allahun natë e ditë e nuk mërzhiten, nuk e di numrin e tyre askush përveç Allahut dhe i ka obliguar Allahu me vepra e detyra të ndryshme. Thotë Allahu i Lartësuar:

ا ... وَلَكِنَّ الْبِرَّ مَنْ وَآمَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَالْمَلَائِكَةِ ... ﴿١٠٧﴾

[Y33: ﴿١٠٧﴾]

“...por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson Allahut, ditës së gjykimit, melekëve...” (El Bekare 177).

ا ... كُلُّ وَآمَنَ بِاللَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ وَكُتُبِهِ وَرُسُلِهِ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ

أَحَدٍ مِّن رُّسُلِهِ ... ﴿١٠٨﴾ [Q108: ﴿١٠٨﴾]

“...Secili i besoi Allahut, melekëve të Tij, shpalljeve të Tij, të Dërguarve të Tij. Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin nga të Dërguarit e Tij...” (El Bekare 285).

Në hadithin e njohur të Xhibrilit, kur u pyet i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem për imanin, islamin dhe ihsanin, Xhibrili i tha: Më trego për imanin? I tha i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “Të besosh Allahun, melekët e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij, Ditën e Fundit dhe të besosh Kaderin qoftë i mirë apo jo i mirë”.

Shkalla e besimit në melekë në Islam:

Besimi në melekë është kushti i dytë në mesin e gjashtë kushteve të imanit, kusht pa të cilin nuk është i saktë dhe nuk pranohet imani i njeriut.

Myslimanët kanë koncensus (ixhma) se besimi në melekët e nderuar është i obliguar, e ai i cili e mohon ekzistencën e tyre, apo ekzistencën e disa prej tyre që i ka përmendur Allahu i Lartësuar, ka mohuar (ka bërë kufër) dhe ka kundërshtuar Kur'anin, Sunnetin dhe Ixhmain (koncenzusin).

Thotë Allahu i Lartësuar:

ا ... وَمَنْ يَكْفُرْ بِاللَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ وَكُتُبِهِ وَرُسُلِهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ

فَقَدْ ضَلَّ ضَلَالًا بَعِيدًا ﴿١٣٦﴾

“...Kush nuk i beson Allahut, engjëjve të Tij, librave të Tij, të dëguarve të Tij dhe botës tjetër, ai ka humbur tepër larg” (En Nisa’ 136).

2.Mënyra e besimit në melekë

Besimi në melekë ka aspektin e përgjithshëm dhe të detalizuar. Besimi në melekë në aspektin e përgjithshme i përmban disa çështje, e prej tyre:

E para: Pranimi i ekzistimit të tyre, se ata janë krijesa nga krijesat e Allahut, i ka krijuar Allahu për ta adhuruar Atë. Ekzistenca e tyre është reale, nëse ne nuk i shohim nuk do të thotë kjo se ato nuk ekzistojnë. Sa e sa prej krijesave të imëta në gjithësi nuk i shohim, po ato në realitet ekzistojnë.

I Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e ka parë Xhibrilin¹⁴ në formën e tij të vërtetë dy herë. Disa

¹⁴ Emër i melekut

Që nuk flasin para Tij, ata veprojnë me urdhërin e Tij”
(El Enbija 26-27).

ا ... لَا يَعْصُونَ اللَّهَ مَا أَمَرَهُمْ وَيَفْعَلُونَ مَا يُؤْمَرُونَ ﴿٢٦﴾ ﴿٢٧﴾

.[﴿٢٦﴾ ﴿٢٧﴾]

“...që nuk e kundërshtojnë Allahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë për të cilën janë të urdhëruara” (Et Tahrir 6).

Kjo pjesë e imanit është e obliguar për çdo mysliman e myslimane, janë të obliguar ta mësojnë dhe ta besojnë, e askush nuk arsyetohet për mosdijen e tij.

Besimi në melekë në aspektin e detalizuar i përmban disa çështje, e prej tyre:

E para: Materia e krijimit të tyre.

I krijoi Allahu i Lartësuar melekët prej dritës ashtu si i krijoi i Madhëruari xhindët prej zjarrit dhe bijtë e Ademit prej dheut. Melekët u krijuan para krijimit të Ademit alejhis salam.

Ka ardhur në hadith: “U krijuan melekët prej dritës, u krijuan xhindët prej zjarrit pa tym dhe u krijua Ademi prej asaj që ju ka përshkruar juve” (Muslimi).

E dyta: Numri i melekëve.

Melekët janë krijesa që nuk e di numrin e tyre askush pos Allahut azze ve xhel-le se janë të shumtë, e nuk gjendet në qiell ndonjë vend sa katër gishtërinj e që nuk ndodhet aty një melek në sexhde apo në këmbë. Ashtu edhe në Bejtul Ma’mur që ndodhet në qiellin e shtatë hyjnë çdo ditë nga 70 mijë melekë, e nuk kthehen kurrë më, e kjo argumenton shumësinë e tyre. Në ditën e Kijametit Zjarri do të ketë 70 mijë mbikqyrës (prej melekëve), e me çdo mbikqyrës nga 70 mijë melekë që i shërbejnë.

Thotë Allahu i Lartësuar:

ا ... وَمَا يَعْلَمُ جُنُودَ رَبِّكَ إِلَّا هُوَ... ﴿[XY: ﴿٢٦٢﴾﴾

“...e ushtrinë e Zotit tënd nuk e di kush pos Atij...” (El Mudeththir 31).

Ka ardhur në hadith se i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “Ka rënkuar qielli dhe ka të drejtë të rënkojë se nuk ka në të ndonjë vend sa shputa e këmbës veçse në të të gjendet ndonjë melek në sexhde dhe në ruku”. Dhe tregon sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem për Bejtul Ma’murin: “Hyjnë në të çdo ditë nga 70 mijë melekë e nuk kthehen më” (Buhariu dhe Muslimi). Gjithashtu sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem tha: “Caktohen për Xhehennemin atë ditë 70 mijë mbikqyrës e me secilin prej tyre nga 70 mijë melekë” (Muslimi).

Këtu na bëhet e qartë se numri i melekëve është i madh, p.sh. këtu arriti numri i tyre në 4,9 miljard melekë. E sa është numri i melekëve tjerë? I madhëruar qoftë Ai që i krijoi dhe e shumësoi numrin e tyre.

E treta: Emrat e melekëve.

Obligohet të besojmë në ata që i emëroi Allahu në Kur’an apo i emëroi i Dërguari i Tij sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem në Sunnet. Melekët më të mëdhenj janë tre:

I pari është Xhibrili, që quhet edhe Xhebrail. Ky është Shpirti i Shenjtë që të Dërguarve alejhimus selam ju zbret Shpalljen me të cilën ngjallen zemrat.

I dyti është Mikaili, që quhet edhe Mikal. Është përgjegjës për shirat që e ngjallin Tokën dhe e sjell shiun aty ku e urdhëron Allahu.

I treti është Israfil. Është i ngarkuar me detyrën e fryerjes së Surit¹⁷, me të cilën përfundon jeta e Dunjasë dhe fillon jeta (e amshuar) e Ahiretit, fryerje që përmban në vete ngjalljen e trupave.

¹⁷ Borisë

E katërta: Cilësitë e melekëve.

Melekët janë krijesa konkrete, kanë trupa konkret, të cilësuar me cilësi trupore e morale e prej cilësive po i cekim këto:

A.*Janë krijesa madhështore me trupa shumë të mëdhenj.* I krijoi Allahu subhanehu ve teala melekët me forma madhështore, të fortë ashtu si ju takon për detyrat e tyre të famshme me të cilat i ka ngarkuar Allahu në qiej dhe tokë.

B.*Kanë krahë.* Allahu subhanehu ve teala ju krijoi melekëve nga dy, tri, katër palë krahë, e edhe më shumë se kaq. I Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem e ka parë Xhibrilin në formën e tij, e i kishte 600 krahë me të cilat e mbulonte tërë horizontin. Thotë Allahu i Lartësuar:

اَلْحَمْدُ لِلّٰهِ فَاطِرِ السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضِ جَاعِلِ الْمَلٰٓئِكَةِ رُسُلًا
اُولٰٓئِىْ اَجْنِحَةٍ مَّثْنٰى وَّثَلٰثَ وَّرُبْعَۃٍ يَزِيْدُ فِى الْخَلْقِ مَا يَشَآءُ ... ﴿٢٠﴾
[Y: ﴿٢٠﴾]

“Falënderimi i goftë Allahut, Krijuesit të qiejve e tokës Sajuesit të engjëjve me nga dy palë, tri palë e katër palë krahë, ndërmjetësues (në mes Tij dhe Pejgamberëve). Ai shton në krijim çka të dojë...” (Fatir 1).

C.*Nuk kanë nevojë për ngrënje e pirje.* Allahu i Madhëruar i krijoi melekët ashtu që ata nuk kanë nevojë për ngrënje e as pirje, nuk martohen e as nuk shumohen.

Ç.*Janë të mençur.* I folën Allahut dhe Ai ju foli atyre, i folën Ademit dhe të Dërguarve.

D.*Kanë mundësi të personifikohen.* Allahu ju dha melekëve mundësinë që ta ndërrojnë pamjen e tyre e të personifikohen në forma të burrave. Ky është kundërshtim i idhujtarëve të cilët pretenduan se melekët janë bijat e Allahut.

Ne nuk e dimë mënyrën e personifikimit të tyre, por e dimë se ata personifikohen, në formë precize, e cila e vështirëson dallimin mes tyre dhe njerëzve.

Dh. Vdekja e melekëve. Melekët vdesin të gjithë në Ditën e Kijametit, me gjithë melekët e vdekjes. Pastaj ringjallen për t'i kryer detyrat me të cilat i ka ngarkuar Allahu.

E. Ibadeti i melekëve. E adhurojnë melekët Allahun e Madhëruar me ibadete të ndryshme siç është namazi, dua, madhërimi¹⁸, rukuja¹⁹, sexhdeja²⁰, frika, droja dhe dashuria e të tjera.

Cilësitë e adhurimeve të tyre janë:

1. Angazhimi dhe vazhdimësia pa kurrëfarë mërzie.
2. Singëriteti (ibadetet bëhen për Allahun).
3. I përmbahen urdhërave dhe ju largohen të ndaluarave pasi që janë të mbrojtur prej mëkateve.
4. Modestia para Allahut me gjithë ibadetin e shumtë. Thotë Allahu i Lartësuar:

اُتْبِخُونِ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ لَا يَفْتُرُونَ ﴿٢٠﴾

[﴿٢٠﴾: ﴿٢٠﴾]

“Ata e lartësojnë (Allahun) natë e ditë dhe nuk mërziën” (El Enbija 20).

E pesta: Punët e melekëve.

I kryejnë melekët disa punë të famshme me të cilat i ka ngarkuar Allahu, e prej atyre punëve:

1. Mbajtja e Arshit.
2. Meleku i ngarkuar me zbritjen e shpalljeve të Dërguarit.
3. Ruajtja e Xhenetit dhe e Zjarrit.
4. Përgjegjësit e reve, shirave dhe bimëve.

¹⁸ Subhanallah

¹⁹ Përlulja

²⁰ Vërja e ballit, hundës, këmbëve e duarve në tokë

5. Përgjegjësit e kodrave.
6. Meleku i obliguar për fryerjen e Surit.
7. Të ngarkuarit me shkrimin e veprave të bijëve të Ademit.
8. Të ngarkuarit me ruajtjen e bijëve të Ademit. Por, kur Allahu e ka caktuar ndonjë çështje për ta (njerëzit), ata e lëjnë të ju ndodh çka është caktuar.
9. Përgjegjësit për shoqërimin e njeriut dhe thirrjen e tij në të mira.
10. Të ngarkuarit me lëngun e ngjizur²¹ në mitër, me vënjën e shpirtit në trupin e fëmijës dhe shkrimin e rizkut e punës së tij, si dhe shkrimin e lumturisë apo jolumturisë së njeriut.
11. Përgjegjësit me marrjen e shpirtërave të bijëve të Ademit në kohën e vdekjes.
12. Të ngarkuarit për marrjen në pyetje të njerëzve në varret e tyre dhe përkujdesja me çka pason për ta, qoftë shpërblim apo dënim.
13. Të ngarkuarit me përcjelljen e selamit tek i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, nga ana e pasuesve të tij.

Kështu nuk ka nevojë myslimani kur dëshiron t'i dërgojë selam Muhammedit alejhis selam të shkojë tek ai (te varri i tij), mirëpo mjafton të qoj salavat e selam për të prej çfarëdo vendi, e melekët e bartin dhe e përcjellin atë selam te i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Por, udhëtimi drejt Xhamisë së Pejgamberit bëhet për t'u falur në të²².

Ata kanë edhe punë tjera të shumta, e këto që i cekëm janë më të njohurat, e këto janë disa prej argumenteve për to:

²¹ Lëng që krijohet pas bashkimit të vezëve mashkullore me ato femërore. Allahu i Madhëruar ka caktuar melekë të posaçëm që japin përgjegjësi për këtë

²² Namazi në Xhaminë e Pejgamberit në Medinë e ka vlerën e 1000 namazeve në xhamitë tjera

ا الَّذِينَ يَحْمِلُونَ الْعَرْشَ وَمَنْ حَوْلَهُ يُسَبِّحُونَ بِحَمْدِ رَبِّهِمْ

وَيُؤْمِنُونَ بِهِ وَيَسْتَغْفِرُونَ لِلَّذِينَ ءَامَنُوا ... ﴿٨٣﴾

“Ndërsa ata (engjëjt) që e bartin Arshin dhe ata që janë përreth tij, lartësojnë me falënderim Zotin e tyre, i besojnë Atij dhe i luten Atij t’i falë ata që besuan ...” (Gafir 7).

ا قُلْ مَنْ كَانَ عَدُوًّا لِّجِبْرِيلَ فَإِنَّهُ نَزَّلَهُ عَلَى قَلْبِكَ بِإِذْنِ اللَّهِ ...

﴿٨٤﴾

“Thuaj:” Kush është armik i Xhibrilit (është armik i Allahut), e ai me urdhërin e Allahut e zbriti Kur’anin në zemrën tënde...” (El Bekare 97).

ا ... وَلَوْ تَرَىٰ إِذِ الظَّالِمُونَ فِي غَمَرَاتِ الْمَوْتِ وَالْمَلَائِكَةُ

بَاسِطُو أَيْدِيهِمْ أَخْرِجُوا أَنْفُسَكُمُ ... ﴿٨٥﴾

“...E, sikur t’i shihje mizorët kur janë në agoni të vdekjes, e engjëjt kanë shtrirë duart e veta (me ndëshkim) e (u thonë): “Shpëtonie pra vetveten (nëse mundeni)”...” (El En’am 93).

E gjashta: Obligimet e njerëzve ndaj melekëve:

-Besimi në ta.

-Dashuria ndaj tyre, madhështimi i tyre dhe përmendja e vlerave të tyre.

-Ndalimi i sharjes së tyre, cungimit (të vlerave) të tyre apo tallja me ta.

-Largimi nga gjërat që i urrejnë melekët, se ata dëmtohen nga gjërat prej të cilave dëmtohen bijtë e Ademit.

3.Frytet e besimit në melekë

- Realizimi i imanit, se imani nuk është i vlefshëm pa besuar në ta.
- Dituria rreth madhësisë së Krijuesit të tyre të Shenjtë e të Lartësuar, forcës së Tij, sepse madhështia e krijimit rrjedh prej madhësisë së Krijuesit.
- Shtimi i imanit në zemrën e besimtarit prej njohjes së cilësive, rrjedhave dhe detyrave të tyre.
- Siguria dhe qetësimi shpirtëror i besimtarëve kur Allahu i forcon me melekë²³.
- Dashuria ndaj melekëve duke patur parasysh punët e tyre, siç janë ibadetet në mënyrë më të përsosur dhe kërkimi i tyre falje për besimtarët.
- Urrejtja e punëve shkatërrimtare dhe mëkateve.
- Falënderimi i Allahut subhanehu ve teala për kujdesin e Tij ndaj robëve të Vet, ashtuqë i obligoi disa prej melekëve që t'i ruajnë ata, t'ju shënojnë veprat e gjëra tjera të dobishme për ta.

²³ E ka qëllimin në kohë lufte

Kushti i tretë: Besimi në libra

Besimi në librat e Allahut të zbritur te të Dërguarit e Tij alejhimus selam është kushti i tretë prej kushteve të imanit. Allahu i Lartësuar i ka dërguar të Dërguarit me sqarime dhe zbriti te ata librat si mëshirë për krijesat dhe udhëzim për ta, ashtuqë ta arrijnë lumturinë në Dunja e Ahiret. Gjithashtu (i zbriti librat) për të pasur një rrugë që të ecin në të dhe për të qenë gjykatës mes njerëzve në gjërat që ata nuk pajtohen.

Thotë Allahu i Lartësuar:

اَلْقَدْ اَرْسَلْنَا رُسُلَنَا بِالْبَيِّنَاتِ وَاَنْزَلْنَا مَعَهُمُ الْكِتَابَ وَالْمِيزَانَ
لِيَقُومَ النَّاسُ بِالْقِسْطِ ... ﴿٢٥١﴾

“Ne i dërguam të Dërguarit Tonë me dokumente të qarta dhe Ne zbritëm me ata librin dhe drejtësinë që t’i përmbahen njerëzit të së drejtës...” (El Hadid 25).

اَكَانَ النَّاسُ اُمَّةً وَاحِدَةً فَبَعَثَ اللَّهُ النَّبِيِّنَ مُبَشِّرِينَ وَمُنْذِرِينَ
وَاَنْزَلَ مَعَهُمُ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ لِيَحْكُمَ بَيْنَ النَّاسِ فِي مَا اَخْتَلَفُوا فِيهِ
﴿٢٥٢﴾

“Njerëzit ishin një popull (të fesë së natyrshme islame) e (kur u përçanë) Allahu dërgoi Pejgamberët përgëzues dhe qortues, dhe atyre Ai u zbriti edhe librin me fakte të sakta për të gjykuar në atë që u kundërshtuan ndërmjet veti...” (El Bekare 213).

1.Realiteti i besimit në libra

Besimi në libra është vërtetim i prerë se Allahu ka libra të cilët i ka zbritur te të Dërguarit e Tij, paqja e mëshira qofshin mbi ta. Ata libra janë me të vërtetë nga fjalët e Tij, janë dritë dhe udhëzim, e ajo që ata përmbajnë është e vërtetë, e sinqertë, drejtësi që duhet të pasohet dhe të punohet me të. Nuk e din numrin e librave askush pos Allahut.

Thotë Allahu i Lartësuar:

ا...وَكَلَّمَ اللَّهُ مُوسَى تَكْلِيمًا ﴿١٦٤﴾ ﴿١٦٤﴾ [Yûsuf: ١٦٤]

“...e Musait i foli Allahu me fjalë” (En Nisa’ 164).

ا وَإِنْ أَحَدٌ مِّنَ الْمُشْرِكِينَ اسْتَجَارَكَ فَأَجْرُهُ حَتَّى يَسْمَعَ كَلِمَ اللَّهِ

﴿١٦٤﴾ [Yûsuf: ١٦٤] ...

“E nëse ndokush prej idhujtarëve të kërkon strehim, ti strehoje në mënyrë që t’i dëgjojë fjalët e Allahut ...” (Et Teube 6).

2.Dispozita e besimit në libra

Obligohemi të besojmë në të gjithë librat të cilët i ka zbritur Allahu te të Dërguarit e Tij, alejhimus selam. Allahu tebareke ve tealë, ka folur me të vërtetë përmes këtyre librave, ata janë të zbritur e jo të krijuar, e ai që i kundërshton ata, apo një pjesë të tyre ka bërë kufër.

Thotë Allahu dhul xhelal:

اَيٰٓأَيُّهَا الَّذِيْنَ ءَامَنُوْا ءَامِنُوْا بِاللّٰهِ وَرَسُوْلِهِۦ ۚ وَٱلْكِتٰبِ الّٰذِى نَزَّلَ
عَلٰى رَسُوْلِهِۦ ۚ وَٱلْكِتٰبِ الّٰذِى اُنْزِلَ مِنْ قَبْلُ ۚ وَمَنْ يَكْفُرْ بِاللّٰهِ
وَمَلَٰئِكَتِهٖ وَكُتُبِهٖ وَرُسُلِهٖ ۙ وَٱلْيَوْمِ الّٰخِرِ فَقَدْ ضَلَّ ضَلٰلًا
بَعِيْدًا ﴿١٣٦﴾ [YXα: ﴿١٣٦﴾]

“O ju që besuat, besoni vazhdimisht Allahut, të Dërguarit të Tij, librit që gradualisht ia shpalli të Dërguarit të Tij dhe librit që e pat zbritur më parë. Kush nuk i beson Allahut, engjëjve të Tij, librave të Tij, të dëguarve të Tij dhe botës tjetër, ai ka humbur tepër larg” (En Nisa’ 136).

وَهٰذَا كِتٰبٌ اُنْزِلْنٰهُ مُبٰرَكٌ مُّبٰرَكٌ فَاتَّبِعُوْهُ وَاتَّقُوْا لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُوْنَ ﴿١٥٥﴾ [YΩΩ: ﴿١٥٥﴾]

“Dhe ky është libër i bekuar, Ne e zbritëm, pasoni atë dhe frigohuni (nga Allahu) ashtu që të mëshiroheni” (El En’am 155).

3.Nevoja e njerëzve për libra dhe urtësia e zbritjes së tyre

- 1.Që të jetë libri i zbritur te i Dërguari bazë për popullin e tij, që të bazohen në të në njohjen e fesë së tyre.
- 2.Që të jetë libri i zbritur te i Dërguari, gjykatës i drejtë për popullin e tij në çdo gjë që nuk pajtohen.
- 3.Që ta ruaj ai libër i zbritur fenë pas vdekjes së të Dërguarit pa marrë parasysh largësinë e vendeve apo kohës,

ashtu siç është rasti në Thirrjen e të Dërguarit tonë Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

4.Që të jenë këta libra argumente për Allahun ndaj krijesave të Tij, e nuk lejohet për ta kundërshtimi i tyre e as dalja prej parimeve të tyre.

Thotë Allahu i Lartësuar:

اَكَانَ النَّاسُ اُمَّةً وَاحِدَةً فَبَعَثَ اللَّهُ النَّبِيِّنَ مُبَشِّرِينَ وَمُنْذِرِينَ
وَأَنْزَلَ مَعَهُمُ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ لِيَحْكُمَ بَيْنَ النَّاسِ فِي مَا اَخْتَلَفُوا فِيهِ
[QX: ﴿٢١٣﴾ ...]

“Njerëzit ishin një popull (të fesë së natyrshme islame) e (kur u përçanë) Allahu dërgoi Pejgamberët përgëzues dhe qortues, dhe atyre Ai u zbriti edhe librin me fakte të sakta për të gjykuar në atë që u kundërshtuan ndërmjet veti” (El Bekare 213).

4.Mënyra e besimit në libra

Besimi në libra ka aspektin e përgjithshëm dhe aspektin e detalizuar. Në aspektin e përgjithshëm besimi në libra është të besosh se Allahu ka zbritur libra te të Dërguarit e Tij, paqja e shpëtimi qoftë mbi ta.

Në aspektin e detalizuar besimi në libra është të besosh librat që i emërtoi Allahu në Kur'anin Fisnik, e mësuam se ata janë Kur'ani, Tevrat, Zeburi, Inxhili, fletushkat (suhufet) e Ibrahimit dhe Musës. Të besosh se Allahu ka edhe libra tjerë që i ka zbritur te të Dërguarit e Tij, e nuk i din emrat e as numrin e tyre askush përveç Atij që i ka zbritur, i Madhëruar e i Lartësuar qoftë.

Gjithë këta libra kanë ardhur që ta vërtetojnë Tevhidin (Njësinë) e Allahut, veçimin e Tij në adhurim, që

ta vërtetojnë punën e mirë, ndalimin nga shirku dhe shkatërrimin në Tokë. Esenca e Thirrjes së të Dërguarve është një, por kanë dallim në ligje e rregulla.

Besimi në libra është pranim i zbritjes së tyre te të Dërguarit e mëparshëm, e besimi në Kur'anin është pranim i tij dhe pasim i asaj që gjendet në të. Thotë Allahu i Lartësuar:

اَوَامِنَ الرَّسُولُ بِمَا اُنْزِلَ اِلَيْهِ مِنْ رَبِّهِ وَالْمُؤْمِنُونَ كُلٌّ وَاٰمَنَ بِاللّٰهِ
وَمَلَٰئِكَتِهِ وَكُتُبِهِ وَرُسُلِهِ ... ﴿١٠٧﴾

“I Dërguari i besoi asaj që iu shpall prej Zotit të Tij, si dhe besimtarët. Secili i besoi Allahut, melekëve të Tij, librave të Tij, të Dërguarve të Tij” (El Bekare 285).

اَتَّبِعُوا مَا اُنْزِلَ اِلَيْكُمْ مِّنْ رَّبِّكُمْ وَلَا تَتَّبِعُوا مِنْ دُونِهِ اَوْلِيَاءَ ... ﴿١٠٨﴾

“Përvetësoni atë që ju është zbritur nga Zoti juaj, e mos pasoni pos Tij evlija (miq, ndihmës, mbrojtës që ju mësojnë të adhuron tjetër kend pos Allahut)” (El A’raf 3).

Kur’ani veçohet nga librat e mëparshëm në disa çështje:

- 1.Ai është mrekulli në tekstin dhe domethënien e tij, në realitetet kosmologjike e shkencore që janë në të.
- 2.Ai është libri i fundit qiellor, me të u përfundua zbritja e librave, ashtu siç u ndërpre Pejgamberia me të Dërguarin tonë Muhammedin sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.
- 3.Allahu e mori përsipër ruajtjen e tij prej çdo shtrembërimi apo ndryshimi. Përkundrazi librat tjerë u shtrembëruan dhe u ndryshuan.
- 4.Ai është vërtetues i librave që janë para tij.

5. Ai është anulues i të gjithë librave të mëparshëm²⁴.

Thotë Allahu i Lartësuar:

أَمَّا كَانَ حَدِيثًا يُفْتَرَىٰ وَلَكِن تَصْدِيقَ الَّذِي بَيْنَ يَدَيْهِ
وَتَفْصِيلَ كُلِّ شَيْءٍ وَهُدًى وَرَحْمَةً لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ ﴿٢٧﴾ ... ﴿٢٨﴾

[YYY: ﴿٢٧﴾ ﴿٢٨﴾]

“Ai (Kur’ani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjta) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson” (Jusuf 111).

5. Pranimi i lajmeve të librave të mëparshëm

Jemi të bindur se lajmet të cilat ju ka shpallur Allahu, të Dërguarve të Vet në librat e mëparshëm, janë të vërteta pa farë dyshimi në to.

Kjo nuk don të thotë që të pranojmë atë që gjendet në librat që i kanë sot Ehli Kitabi²⁵, se ata janë shtrembëruar e ndryshuar e nuk kanë mbetur në origjinalitetin në të cilin i ka zbritur Allahu te të Dërguarit e Tij alejhimus salatu ves selam.

Ajo që e dimë sigurt nga ata libra është ajo që na ka lajmëruar Allahu në Librin e Tij (Kur’anin) ku thotë:

أَمْ لَمْ يُنَبِّأْ بِمَا فِي صُحُفِ مُوسَىٰ ﴿٢٧﴾ وَإِبْرَاهِيمَ الَّذِي وَفَّىٰ ﴿٢٨﴾
أَلَّا تَزِرُ وَازِرَةٌ وِزْرَ أُخْرَىٰ ﴿٢٩﴾ وَأَن لَّيْسَ لِلْإِنسَانِ إِلَّا مَا سَعَىٰ

²⁴ Anulues i rregullave dhe ligjeve që gjinden në ta, e jo mohues i tyre.

²⁵ Jehuditë dhe kristianët

﴿٣٦﴾ وَأَنَّ سَعْيَهُ سَوْفَ يُرَى ﴿٣٧﴾ ثُمَّ يُجْزَاهُ الْجَزَاءُ الْأَوْفَى ﴿٣٨﴾
 [١٧- Xa: ﴿٣٦﴾ ﴿٣٧﴾ ﴿٣٨﴾]

“Apo nuk është informuar me atë që është në fletushkat e Musait dhe të Ibrahimit, që gjithnjë i plotësoi obligimet. (Që në to shkruan) se askush nuk e bartë barrën (mëkatin) e tjetrit dhe se njeriut nuk i takon tjetër vetëm se ajo që ka punuar dhe se munda i tij më vonë (ditën e gjyimit) do të shihet, pastaj ai shpërblehet me shpërblimin më të plotë” (En Nexhm 36-41).

بَلْ تُؤْثِرُونَ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا ﴿١٦﴾ وَالْآخِرَةَ خَيْرٌ وَأَبْقَى ﴿١٧﴾ إِنَّ هَذَا لَفِي الصُّحُفِ الْأُولَى ﴿١٨﴾ صُحُفِ إِبْرَاهِيمَ وَمُوسَى ﴿١٩﴾ ﴿٢٠﴾
 [YD- Ya: ﴿١٦﴾ ﴿١٧﴾ ﴿١٨﴾ ﴿١٩﴾ ﴿٢٠﴾]

“Po ju i jepni përparësi jetës së kësaj bote, e dihet se jeta e botës tjetër është më e dobishme dhe e përjetshme. Vërtet, kjo (këshillë) gjendej edhe në broshurat e para: në broshurat e Ibrahimit dhe të Musait” (El A’la 16-19).

Sa ju përket rregullave të tyre: Ato që gjenden në Kur’an jemi të obliguar t’ju nënshtrohemi, në dallim prej atyre që gjenden në librat e mëparshëm, së pari shikojmë se mos janë në kundërshtim me ligjin tonë, (e nëse janë) nuk punojmë me to, jo se janë të kota, por se janë të vërteta për kohën e tyre e ne nuk jemi të obliguar me ato ligje, se janë anuluar me ligjin tonë. E nëse përkojnë me ligjin tonë, atëherë janë të vërteta dhe ligji ynë e argumenton saktësinë e tyre.

6.Librat qiellor që janë përmendur në Kur'an e Sunnet

1.Kur'ani Fisnik

Kur'ani është Fjalë e Allahut që i ka zbritur Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, të Dërguarit të fundit. Është libri i fundit që zbriti, Allahu e mori përsipër ruajtjen e tij prej shtrembërimeve dhe ndryshimeve dhe e bëri anulues të librave tjerë. Thotë Allahu i Lartësuar:

إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا الذِّكْرَ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ ﴿١﴾
[8:255]

“Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij” (El Hixher 9).

وَأَنزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ مُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنَ
الْكِتَابِ وَمُهَيْمِنًا عَلَيْهِ فَاحْكُم بَيْنَهُم بِمَا أَنزَلَ اللَّهُ... ﴿٢٤٦﴾
[47:246]

“Ne edhe ty (Muhammed) ta zbritëm librin (Kur'anin) e vërtetë që është vërtetues i librave të mëparshme dhe garantues i tyre. Gjyko, pra, mes tyre me atë që Allahu e zbriti...” (El Maide 48).

2.Tevrati

Tevrati është libri që Allahu ia zbriti Musait alejhis selam dhe e bëri udhëzim e dritë, që të gjykojnë me të të Dërguarit e Beni Israilëve dhe rabinët²⁶ e tyre.

²⁶ Prijës fetar të Beni Israilët dhe të jehuditë sot

Tevrati në të cilin jemi të obliguar të besojmë, është ai që Allahu ia zbriti Musait alejhis selam, e nuk është Tevrati ekzistues i shtrembëruar që e kanë sot Ehli Kitabi.

Thotë Allahu i Lartësuar:

إِنَّا أَنْزَلْنَا التَّوْرَةَ فِيهَا هُدًى وَنُورٌ يَحْكُمُ بِهَا النَّبِيُّونَ الَّذِينَ أَسْلَمُوا لِلَّذِينَ هَادُوا وَالرَّبَّانِيُّونَ وَالْأَحْبَارُ بِمَا اسْتُحْفِظُوا مِنْ كِتَابِ اللَّهِ... ﴿٢٤٣﴾ [٢٤٣].

“Vërtetë që Ne ia zbritëm Tevratin (Musait) dhe aty pati udhëzim dhe dritë, me anë të të cilit Pejgamberët që iu nënshtruan Vullnetit të Allahut plotësisht, gjykuan dhe udhëhoqën çifutët. (Po kështu) edhe rabbinët, edhe udhëheqësit dijetarë të fesë, sepse atyre iu ishte besuar mbrojtja e Librit të Allahut...” (El Maide 44).

3.Inxhili

Inxhili është libri që Allahu ia zbriti Isait alejhis selam me të vërtetën, si vërtetues i librave qiellorë që zbritën para tij.

Inxhili në të cilin jemi të obliguar të besojmë, është ai që Allahu ia zbriti Isait alejhis selam me bazat e veta të shëndosha, e nuk janë ungjijtë e shtrembëruar që gjenden sot te Ehli Kitabi.

Thotë Allahu i Lartësuar:

وَقَفَّيْنَا عَلَىٰ نَوَائِرِهِم بِعِيسَى ابْنِ مَرْيَمَ مُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنَ التَّوْرَةِ وَنَوَاتِنَاهُ الْإِنجِيلَ فِيهِ هُدًى وَنُورٌ وَمُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ

يَدِيهِ مِنَ التَّوْرَةِ وَهُدًى وَمَوْعِظَةً لِّلْمُتَّقِينَ ﴿٤٦﴾

[46: ﴿﴾]

“Ne vazhduam gjurmët e tyre (të Pejgamberëve) me Isain, birin e Merjemes, vërtetues i Tevratit që kishin më parë. Atij i dhamë Inxhilin, që është udhëzim i drejtë dhe dritë, që është vërtetues i Tevratit që kishin pranë, që ishte udhëzues e këshillues për të devotshmit” (El Maide 46).

Prej asaj që përmbanin Tevratit e Inxhili ishte edhe përgëzimi për dërgimin e të Dërguarit tonë Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Thotë Allahu i Lartësuar:

اَلَّذِينَ يَتَّبِعُونَ الرَّسُولَ النَّبِيَّ الَّذِي يَجِدُونَهُ مَكْتُوبًا عِنْدَهُمْ فِي التَّوْرَةِ وَالْانْجِيلِ يَأْمُرُهُمْ بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَاهُمْ عَنِ الْمُنْكَرِ وَيُحِلُّ لَهُمُ الطَّيِّبَاتِ وَيُحَرِّمُ عَلَيْهِمُ الْخَبَائِثَ وَيَضَعُ عَنْهُمْ اَصْرَهُمْ وَالْأَغْلَالَ الَّتِي كَانَتْ عَلَيْهِمْ ... ﴿٧٢﴾

[72: ﴿﴾]

“Ata të cilët e ndjekin të Dërguarin, Pejgamberin që s’di të shkruaj e as të lexojë të cilin e gjejnë të shkruar në Tevrat që e kanë në duart e tyre dhe në Inxhil; ai i urdhëron ata për të mira dhe i ndalon nga të këqijat; u lejon atyre si të ligjshme të mirat dhe ua ndalon si të paligjshme të ndytat; ai i çliron ata nga barrët e rënda dhe nga prangat që qenë mbi ta...”²⁷ (El A’raf 157).

²⁷ Është e shprehur qartë në Tevrat dhe në Inxhil, edhe pse librat e parë janë ndryshuar dhe shfytëruar, prapëseprapë profeci të qarta tregojnë për ardhjen e Pejgamberit Muhammed sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, si për shembull te: Deuteronomi 18:18, 21:21; Psallmet 118:22-23; Isaia 42:1-13; Hab 3:3-4; Mateu 21:42-43; Xhoni 14:12-17, 14:26-28, 16:7-14 e tjerë

4.Zeburi

Zeburi është libri që Allahu ia zbriti Davudit alejhis selam. Zeburi në të cilin jemi të obliguar të besojmë është ai që Allahu ia zbriti Davudit alejhis selam e nuk janë shtrembërimet që i futën aty jehuditë. Thotë Allahu i Lartësuar:

ا... وَوَاتَيْنَا دَاوُودَ زَبُورًا ﴿١١٣﴾ ﴿١١٢﴾ [Yox: ﴿١١٣﴾ ﴿١١٢﴾]

“...e Davudit i patëm dhënë Zeburin” (En Nisa’ 163).

5.Fletushkat e Ibrahimt dhe Musait

Këto janë fletushkat që Allahu iu dhuroi Ibrahimit dhe Musait alejhimas selam. Fletushkat janë humbur e nuk dihet gjë prej tyre përveç asaj që është përmendur në Kur’anin Fisnik dhe Sunnet.

Thotë Allahu i Lartësuar:

اَمْ لَمْ يُنَبَّأْ بِمَا فِي صُحُفِ مُوسَىٰ ﴿٣٨﴾ وَاِبْرٰهِيْمَ الَّذِي وَفَّىٰ ﴿٣٧﴾
اَلَّا تَزِرُ وَازِرَةٌ وِزْرَ أُخْرٰى ﴿٣٩﴾ وَاَنْ لَّيْسَ لِلْاِنْسٰنِ اِلَّا مَا سَعٰى ﴿٤٠﴾
﴿٤١﴾ وَاَنْ سَعِيْهُ سَوْفَ يُرٰى ﴿٤٢﴾ ثُمَّ يُجْزٰىهُ الْجَزَآؤُ الْاَوْفٰى ﴿٤٣﴾ ﴿٤٤﴾
[Ψ- Xα: ﴿٤٤﴾ ﴿٤٣﴾]

“Apo nuk është informuar me atë që është në fletushkat e Musait. Dhe të Ibrahimit, që gjithnjë i plotësoi obligimet. (Që në to shkruan) Se askush nuk e bartë barrën (mëkatin) e tjetrit dhe se njeriut nuk i takon tjetër vetëm se ajo që ka punuar dhe se mundi i tij më vonë (ditën e gjyimit) do të shihet Pastaj ai shpërblehet me shpërblimin më të plotë” (En Nexhm 36-41).

ا بَلْ تُؤَثِّرُونَ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا ﴿١٦﴾ وَالْآخِرَةَ خَيْرٌ وَأَبْقَى ﴿١٧﴾ إِنَّ
 هَذَا لَفِي الصُّحُفِ الْأُولَى ﴿١٨﴾ صُحُفِ إِبْرَاهِيمَ وَمُوسَى ﴿١٩﴾ ﴿٢٠﴾
 .[Yδ- Yα:↔] * 2 [↔] * 2 [↔]

**“Po ju i jepni përparësi jetës së kësaj bote, E dihet se
 jeta e botës tjetër është më e dobishme dhe e përjetshme.
 Vërtet, kjo (këshillë) gjendej edhe në broshurat e para:
 Në broshurat e Ibrahimit dhe të Musait” (El A’la 16-19).**

Kushti i katërt: Besimi në të Dërguarit **(Pejgamberët²⁸)**

1. Besimi në të Dërguarit alejhimus selam

Është një nga kushtet e imanit, e nuk realizohet imani pa këtë besim.

Besimi në të Dërguarit është bindje e prerë se Allahu ka të Dërguarit e Vet që i ka zgjedhur për ti përcjell dërgesat (shpalljet) e Tij, e ai që i pason ata është i udhëzuar, e ai që nuk ju bindet atyre është i humbur. Ata përcjellën atë që ju zbriti Allahu në mënyrë të qartë, e kryen detyrën²⁹ e vet, e këshilluan popullin, luftuan në rrugën e Allahut me një përpjekje të vërtetë, i paraqitën argumentet, e nuk ndryshuan asgjë, e as nuk shtrembëruan, e as nuk kanë fshehur diçka nga shpallja me të cilën u dërguan. I besojmë të gjithë ata (të dërguarë) që i ka emërtuar Allahu dhe që nuk i ka emërtuar, e çdo i dërguar përgëzon për të Dërguarin që vjen pas tij, e (i Dërguari) i fundit prej tyre i vërteton ata që ishin para tij.

Thotë Allahu i Lartësuar:

اَقُولُوا وَاٰمَنَّا بِاللّٰهِ وَمَا اُنْزِلَ اِلَيْنَا وَمَا اُنْزِلَ اِلَىٰ اِبْرٰهٖمَ
وَاسْمٰعٖلَ وَاِسْحٰقَ وَيَعْقُوبَ وَالْاَسْبَاطِ وَمَا اُوْتِيَ مُوسٰى وَعِيسٰى

²⁸ Gjatë tekstit do të përdoret edhe fjala “Pejgamber” edhe “i dërguar” që kanë kuptim të njëjtë

²⁹ E kryen emanetin që ju dha Allahu

وَمَا أُوتِيَ النَّبِيُّونَ مِنْ رَبِّهِمْ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ أَحَدٍ مِنْهُمْ وَنَحْنُ لَهُ
مُسْلِمُونَ ﴿١٣٦﴾ [YXα: ...]

“Ju (besimtarë) thuani: “Ne i besuam Allahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is’hakut, Jakubit dhe nipave³⁰, atë që i është dhënë Musait, Isait dhe atë që iu është dhënë nga Zoti i tyre Pejgamberëve, ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetëm atij i jemi bindur” (El Bekare 136).

Ai që e përgënjeshtroi një të dërguar e ka përgënjeshtuar Atë që e ka vërtetuar atë (të dërguar), e kush nuk i bindet atij nuk i është bindur Atij që ka urdhëruar për pasimin e tij. Thotë i Lartësuar:

إِنَّ الَّذِينَ يَكْفُرُونَ بِاللَّهِ وَرُسُلِهِ وَيُرِيدُونَ أَنْ يُفَرِّقُوا بَيْنَ اللَّهِ وَرُسُلِهِ وَيَقُولُوا نُؤْمِنُ بِبَعْضٍ وَنَكْفُرُ بِبَعْضٍ وَيُرِيدُونَ أَنْ يَتَّخِذُوا بَيْنَ ذَلِكَ سَبِيلًا ﴿١٥٠﴾ أُولَٰئِكَ هُمُ الْكَافِرُونَ حَقًّا وَأَعْتَدْنَا

لِلْكَافِرِينَ عَذَابًا مُّهِينًا ﴿١٥١﴾ [YQY LYQY: ...]

“S’ka dyshim se ata që nuk besojnë Allahun dhe të Dërguarit e Tij, dëshirojnë të bëjnë dallim mes Allahut dhe të Dërguarve të Tij e thonë: “Ne i besojmë disa e nuk i besojmë disa të tjerë” e duan të marrin rrugë mes kësaj. Të tillët janë jobesimtarët e vërtetë; e Ne kemi përgatitur dënim të fortë e nënçmues për jobesimtarët” (En Nisa’ 150-151).

2.Realiteti i Pejgamberisë

³⁰ Nipat janë djemtë e Jakubit dhe pasardhësit e tyre

Pejgamberia është ndërmjetësim mes Krijuesit dhe krijesave, në përcjelljen e ligjit të Tij, mirësi që Allahu ja dhuron kujt të dojë prej robëve të Tij, e zgjedh (për të dërguar-Pejgamber) kënd të dojë prej krijesave të Tij, e nuk i takon kujt zgjedhja pos Allahut, i Madhëruar qoftë. Thotë Allahu xhel-le shanuhu:

اَللّٰهُ يَصْطَفِيْ مِنَ الْمَلٰٓئِكَةِ رُسُلًا وَمِنْ النَّاسِ اِبْرٰهٖمَ
سَمِيعٌ بَصِيْرٌ ﴿٧٥﴾ ﴿٧٦﴾

“Allahu zgjedh të dërguar prej engjëjve dhe prej njerëzve, Allahu dëgjon e sheh” (El Haxh 75).

Pejgamberllëku dhurohet e nuk fitohet, as nuk arrihet me respekt e adhurim të shumtë (ndaj Allahut), as nuk vjen me zgjedhje apo kërkesë të të Dërguarit, por, është zgjedhje vetëm e Allahut azze ve xhel-le. Thotë Allahu i Lartësuar:

اَللّٰهُ يَجْتَبِيْ اِلَيْهِ مَن يَشَآءُ وَيَهْدِيْ اِلَيْهِ مَن يُنِيبُ ﴿٧٧﴾ ﴿٧٨﴾
[YX: ﴿٧٩﴾ ﴿٨٠﴾]

“Allahu veçon për Të atë që do dhe e udhëzon atë që i drejtohet Atij” (Esh shura 13).

3.Urtësia e dërgimit të Pejgamberëve

Urtësia e dërgimit të Pejgamberëve shëmbëllet me shumë çështje e prej tyre:

E para-Nxjerrja e robërve nga adhurimi i robërve në adhurimin e Zotit të robëve dhe nga robëria e adhurimit të krijesës në lirinë e adhurimit të Zotit të robëve. Thotë Allahu i Lartësuar:

۱ وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ

“E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat” (El Enbija 107).

E dyta-Njohja e qëllimit për të cilin Allahu i krijoi krijesat, e ai qëllim është adhurimi i Tij dhe njësimi i Tij, qëllim ky që nuk njihet veçse përmes të Dërguarve, që Allahu i zgjedhi prej krijesave të Tij dhe i nderoi ata mbi të gjithë njerëzimin (dhe botët). Thotë i Lartësuari:

١ وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَّسُولًا أَنِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا

**“Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t’u thonë:
“Adhuron vetëm Allahun, e largonu djajve (adhurimit
të tyre)!...” (En Nahl 36).**

E treta-Paraqitja e argumenteve para njerëzve me dërgimin e Pejgamberëve. Thotë i Lartësuari:

الرُّسُلَا مُبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَ لِئَلَّا يَكُونَ لِلنَّاسِ عَلَى اللَّهِ حُطَّةٌ بَعْدَ

“Të dërguar që ishin lajmëzues e kërcënues, ashtu që pas dërgimit të Dërguarve njerëzit të mos kenë arsye shfajësimi para Allahut. Allahu është kurdoherë i Gjithëfuqishëm, më i Urti Gjithëgjykues” (En Nisa’ 165).

E katërta-Sqarimi i disa gjërave të fshehta që nuk i arrijnë njerëzit me mendjet e tyre, siç janë Emrat e Allahut dhe Cilësitë e Tij, njohja e melekëve, Ditës së Gjykimit e të tjera.

E pesta-Të qenit e Pejgamberëve shembuj të mirë, duke pasur parasysh se Allahu i plotësoi ata me moral të lartë, dhe i ruajti ata prej dyshimeve dhe epsheve. Thotë i Lartësuari:

أُولَئِكَ الَّذِينَ هَدَى اللَّهُ فَبِهِدْلَهُمْ أَقْتَدَهُ... ﴿٧٩﴾
[δτ:↔]

“Ata (të Dërguarit e përmedur) ishin që Allahu i vuri në rrugë të drejtë, andaj ti merri shembull në udhëzim” (El En’am 90).

لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِيهِمْ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ... ﴿٨٠﴾ [α:↔]

“Me të vërtetë që tek ata pati shembull të shkëlqyer për ju për të ndjekur...” (El Mumtehine 6).

E gjashta-Përmirësimi i shpirtërave, pastrimi dhe shkëlqimi i tyre, dhe tërheqja e vërejtjes ndaj tyre, nga çdo gjë që i ndytë. Thotë Allahu i Lartësuar:

هُوَ الَّذِي بَعَثَ فِي الْأُمِّيِّينَ رَسُولًا مِنْهُمْ يَتْلُو عَلَيْهِمْ آيَاتِهِ وَيُزَكِّيهِمْ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ... ﴿٨١﴾ [Φ:↔]

“Ai është që të pashkolluarve u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre që t’ju lexojë ajetet e Tij, t’i pastrojë ata, t’ua mësojë librin dhe urtësinë...” (El Xhum’a 2).

Thotë i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “Me të vërtetë jam dërguar që t’i përsosi vlerat e moralit” (Transmetojnë Ahmedi dhe Hakimi).

4.Detyrat e të Dërguarve alejhimus selam

Pejgamberët kanë detyra të famshme, po i përmendi disa prej tyre:

A.Paraqitja e legjislaturës (shariatit) dhe thirrja e njerëzve në adhurimin e Allahut të Vetëm dhe largimin nga adhurimi i dikujt tjetër pos Tij. Thotë Allahu i Lartësuar:

الَّذِينَ يُبَلِّغُونَ رِسَالَاتِ اللَّهِ وَيَحْشَوْنَهُ وَلَا يَخْشَوْنَ أَحَدًا إِلَّا اللَّهَ

وَكَفَى بِاللَّهِ حَسِيبًا ﴿٣٩﴾ [Xh: 39]

“Ata, të cilët i kumtojnë shpalljet e Allahut, i frikësohen vetëm Allahut e askujt tjetër pos Tij, e Allahu mjafton të jetë llogaritës” (El Ahzab 39).

B.Sqarimi i fesë. Thotë Allahu i Lartësuar qoftë:

بِالْبَيِّنَاتِ وَالزُّبُرِ وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ

إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ ﴿٤٤﴾ [Yh: 44]

“...Ty ta zbritëm Kur'anin që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, me shpresë se do ta studiojnë” (En Nahl 44).

C.Udhëzimi i popullit drejt të mirës dhe largimi i tyre nga e keqja, përgëzimi i tyre me shpërblim dhe kërcënimi i tyre me dënim. Thotë Allahu i Lartësuar:

الرُّسُلَ مُبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَ... ﴿٦٥﴾ [Yh: 65]

“Të dërguar që ishin lajmgëzues e kërcënues...” (En Nisa 165).

Ç.Përmirësimi i njerëzve me shembull të mirë e mostër të përsosur si në fjalë ashtu edhe në punë.

D.Paraqitja e ligjeve të Allahut ndër njerëz dhe zbatimi i tyre.

DH.Dëshmimi i të Dërguarve ndaj popujve të vet në Ditën e Kijametit se ju kanë përcjellur qartë (misionin e tyre). Thotë Allahu xhel-le shanuhu:

ا فَكَيْفَ اِذَا جِئْنَا مِنْ كُلِّ اُمَّةٍ بِشَهِيدٍ وَجِئْنَا بِكَ عَلَى هَؤُلَاءِ
شَهِيدًا ﴿٤١﴾

“Dhe si do të jetë gjendja e atyre (që nuk besuan), kur Ne do të sjellim dëshmitarë për çdo popull, e ty do të sjellim dëshmitarë mbi ata (që nuk besuan)?” (En Nisa’ 41).

5. Islami është feja e të gjithë të Dërguarve

Islami është feja e të gjithë të Dërguarve nebijë dhe resulë³¹. Thotë Allahu xhel-le shanuhu:

اِنَّ الدِّيْنَ عِنْدَ اللّٰهِ الْاِسْلَامُ ﴿١٩٨﴾

“Feja e pranueshme tek Allahu është islami...” (Ali Imran 19).

Që të gjithë thërrasin në adhurimin e Allahut të Vetëm dhe largimin nga adhurimi i tjetërkujt pos Tij. Edhe nëse dalluan ligjet e normat e tyre, ata janë të bashkuar në një esencë e ajo është Njësimi (i Allahut-tevhidi). Thotë Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “Pejgamberët janë vëllezër...” (Buhariu).

6. Të Dërguarit janë njerëz që nuk e dinë të fshehtën (gajbin)

Dituria mbi të fshehtën është prej cilësive Hyjnore e nuk është prej cilësive të të Dërguarve, sepse ata janë njerëz

³¹ Dy lloje Pejgamberësh. **Nebij** janë Pejgamberët që nuk kanë legjislaturë të re por thërrasin në ligjet e të Dërguarve para tyre, e **Resul** janë Pejgamberët që kanë legjislaturë të re

si njerëzit e tjerë. Ata hanë e pinë, martohen, flejnë, sëmuren dhe lodhen. Thotë i Lartësuar:

اَوْ مَا أَرْسَلْنَا قَبْلَكَ مِنَ الْمُرْسَلِينَ إِلَّا إِنَّهُمْ لَيَأْكُلُونَ

الطَّعَامَ وَيَمْشُونَ فِي الْأَسْوَاقِ... ﴿٢٠﴾ [Xy: ﴿٢٠﴾]

“Ne para teje dërguam Pejgamberë të tjerë, por edhe ata ishin të dërguar që kanë ngrënë ushqim, që kanë ecur e shetitur nëpër tregje...” (El Furkan 20).

ا وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا رُسُلًا مِّن قَبْلِكَ وَجَعَلْنَا لَهُمْ أَزْوَاجًا وَذُرِّيَّةً ﴿٢١﴾

[Xy: ﴿٢١﴾]

“Ne dërguam edhe para teje të dërguar dhe atyre u mundësuam të kenë gra e fëmijë...” (Er Ra’d 38).

Gjithashtu ata (të Dërguarit) përjetojnë atë që e përjetojnë njerëzit tjerë, si brengosja, gëzimi, përpjekja dhe aktiviteti. Veçse ata i zgjedhi Allahu që ta përcjellin fenë e Tij, nuk e dinë të fshehtë, përveç asaj që ju ka treguar Allahu. Thotë Zoti, qoftë i Lartësuar:

اَعَلِمَ الْغَيْبُ فَلَا يُظْهِرُ عَلَى غَيْبِهِ أَحَدًا ﴿٢٢﴾ إِلَّا مَن ارْتَضَىٰ مِن

رَّسُولٍ فَإِنَّهُ يَسْلُكُ مِن بَيْنِ يَدَيْهِ وَمِنْ خَلْفِهِ رَصَدًا ﴿٢٣﴾ ﴿٢٣﴾

[Xy: ﴿٢٣﴾]

“(Ai i Vetëm është) i Gjithdituri i Gajbit (i të panjohurës, fshehtësive) dhe askujt nuk ia shpall fshehtësinë e Tij. Përveç ndonjë të Dërguari të cilin Ai e ka zgjedhur dhe pastaj Ai bën një grup (melekësh) roje të ecin para tij dhe pas tij” (El Xhinn 26-27).

7. Pagabueshmëria e Pejgamberëve

Allahu subhanehu ve teala i zgjodhi për dërgesën e Tij dhe përcjelljen e saj krijesat me të vlefshme, më të përsosurat në moral e fizionomi. Kështu i ruajti ata nga mëkatet e mëdha, e i largoi nga çdo e metë, në mënyrë që ta dërgojnë shpalljen e Allahut te popujt e tyre, duke qenë të pagabuar në atë që e lajmërojnë nga Allahu, i Madhëruar qoftë, gjatë përcjelljes së dërgesës së Tij. E në këtë (pagabueshmërinë e tyre) ka koncenzus të Ummetit. Thotë Allahu i Lartësuar:

اَيُّهَا الرَّسُولُ بَلِّغْ مَا أُنْزِلَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ وَإِنْ لَمْ تَفْعَلْ فَمَا بَلَغْتَ رِسَالَتَهُ وَاللَّهُ يَعْصِمُكَ مِنَ النَّاسِ ﴿٦٧﴾ [Al-Maide: 67]

“O ti i dërguar! Komunikojë atë që t’u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk bën (kumtimin në tërësi), atëherë nuk e ke kryer përcjell dërgesën e Tij. Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve...” (El Maide 67).

الَّذِينَ يُبَلِّغُونَ رِسَالَاتِ اللَّهِ وَيَخْشَوْنَهُ وَلَا يَخْشَوْنَ أَحَدًا إِلَّا اللَّهَ... ﴿٣٩﴾ [Al-Ahzab: 39]

“Ata, të cilët i kumtojnë shpalljet e Allahut, i frikësohen vetëm Allahut e askujt tjetër pos Tij...” (El Ahzab 39).

لِيَعْلَمَ أَنْ قَدْ أَبْلَغُوا رِسَالَاتِ رَبِّهِمْ وَأَحَاطَ بِمَا لَدَيْهِمْ وَأَحْصَىٰ كُلَّ شَيْءٍ عَدَدًا ﴿٢٨﴾ [Al-Hinn: 28]

“Për ta ditur (për t’u dukur) se ata kanë kumtuar shpalljet e Zotit të tyre, dhe se Ai ka përfshi atë te ata, dhe Ai e di sasinë e çdo gjëje që ekziston” (El Xhinn 28).

E nëse iu shpëton ndonjë mëkat i vogël, që nuk ka lidhje me shpalljen, ai (i Dërguari) iu sqaron atyre (popullit), dhe menjëherë pendohen tek Allahu e kthehen tek Ai, e (ai mëkat bëhet) sikur të mos ishte fare. Arrijnë me këtë një gradë më të lartë nga ajo që e kishin më herët, e kjo për shkak se Allahu i veçoi Pejgamberët e Tij, paqja dhe shpëtimi qofshin për ta, me moral të përsosur, cilësi të mira dhe i çrrënjosi nga çdo gjë që e konteston vlerën dhe pozitën e tyre.

8. Numri i të Dërguarve (nebijë dhe resulë) dhe më të veçuarit prej tyre

Është vërtetuar se numri i të Dërguarve Resul, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin për ta, është mbi treqind e dhjetë. Kjo gjindet në fjalën e të Dërguarit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kur është pyetur mbi numrin e Resulëve: “Treqind e pesëmbëdhjetë” (El Hakimi). E të Dërguarit Nebijë janë më shumë. Ka prej tyre (Pejgamberëve) që Allahu na ka treguar për ta në Librin e Tij, e ka edhe që nuk na ka treguar për ta. Allahu i ka përmendur me emra në Librin e Tij 25 të dërguar, nebijë dhe resulë. Thotë Allahu i Lartësuar:

ا وَرُسُلًا قَدْ قَصَصْنَاهُمْ عَلَيْكَ مِنْ قَبْلُ وَرُسُلًا لَمْ نَقْصُصْهُمْ عَلَيْكَ... ﴿٢٥﴾

“Dhe (dërguam) të dërguar më parë që të rrëfyem për ta, dhe të dërguar të tjerë për të cilët nuk të rrëfyem...”
(En Nisa’ 163).

اَوْتِلْكَ حُطَّتْنَا وَاتَيْنَاهَا اِبْرَاهِيمَ عَلَى قَوْمِهِ نَرْفَعُ دَرَجَتِ مَنْ
 نَشَاءُ اِنَّ رَبَّكَ حَكِيمٌ عَلِيمٌ ﴿٨٣﴾ وَوَهَبْنَا لَهُ اِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ
 كُلًّا هَدَيْنَا وَنُوحًا هَدَيْنَا مِنْ قَبْلُ وَمِنْ ذُرِّيَّتِهِ دَاوُدَ
 وَسَلِيمَانَ وَيُثُوبَ وَيُوسُفَ وَمُوسَى وَهَارُونَ وَكَذَلِكَ نَظَرِي
 الْمُحْسِنِينَ ﴿٨٤﴾ وَزَكَرِيَّا وَيَحْيَى وَعِيسَى وَإِلْيَاسَ كُلٌّ مِّنَ
 الصَّالِحِينَ ﴿٨٥﴾ وَاسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ وَيُونُسَ وَلُوطًا وَكُلًّا
 فَضَّلْنَا عَلَى الْعَالَمِينَ ﴿٨٦﴾ وَمِنْ اٰبَائِهِمْ وَذُرِّيَّتِهِمْ وَاٰخَوَانِهِمْ
 وَاجْتَبَيْنَاهُمْ وَهَدَيْنَاهُمْ اِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ﴿٨٧﴾ ﴿٨٧﴾

[yβ-γX:↔]→

“Këto janë argumentet tona që ia dhamë Ibrahimit kundër popullit të tij. Ne ngrisim në shkallë të lartë atë që duam. Zoti yt çdo send e vë në vendin e vet, asgjë nuk mund t’i fshehet. Ne atij (Ibrahimit) i falëm Is-hakun dhe Jakubin dhe secilin prej tyre e udhëzuam. Më parë edhe Nuhun e patëm udhëzuar. E nga pasardhësit e tij (të Ibrahimit) udhëzuam Davudin, Sulejmanin, Ejjubin, Jusufin, Musain dhe Harunin. Kështu i shpërblejmë bamirësat. (shpërblyem) Edhe Zekerijanë, Jahjanë, Isain, Ilijasin të gjithë prej të mirëve të përsosur. (shpërbylem) Edhe Ismailin, Eljesanë, Junusin dhe Lutin. Të gjithë këta i veçuam mbi njerëzit tjerë. Edhe disa nga prindërit, nga pasardhësit dhe nga vëllezërit e tyre i zgjodhëm (për Pejgamberë) dhe i udhëzuam në rrugë të vërtetë” (El En’am 83-87).

Allahu i veçoi disa nebijë nga të tjerët. Thotë i Lartësuari:

ا... وَلَقَدْ فَضَّلْنَا بَعْضَ النَّبِيِّنَ عَلَىٰ بَعْضٍ... ﴿٥٥﴾

[LXIII: 55] → [M: 55]

“...Ne kemi dalluar disa Pejgamberë (nebijë) nga të tjerët...” (El Isra 55).

Gjithashtu Allahu i veçoi edhe disa resulë nga të tjerët. Thotë i Lartësuari:

ا تِلْكَ الرُّسُلُ فَضَّلْنَا بَعْضَهُمْ عَلَىٰ بَعْضٍ... ﴿٢٥٣﴾

[LXXIII: 253] → [CX: 253]

“Këta (për të cilët të rrëfyem) janë resulë, disa prej tyre i dalluam nga të tjerët” (El Bekare 253).

E më të mirët prej tyre janë Ulul Azmi (Të Dërguarit e vendosur), që janë prej të Dërguarve resulë. Ata janë Nuhi, Ibrahim, Musa, Isa dhe i Dërguari jonë Muhammedi alejhimus selam. Thotë i Madhëruari:

ا فَاصْبِرْ كَمَا صَبَرَ أُولُو الْعَزْمِ مِنَ الرُّسُلِ... ﴿٣٥﴾

[LIII: 35] → [XQ: 35]

“Ti (Muhammed) duro, ashtu sikurse duruan të Dërguarit e vendosur...” (El Ahkaf 35).

ا وَإِذْ أَخَذْنَا مِنَ النَّبِيِّنَ مِيثَقَهُمْ وَمِنْكَ وَمِنْ نُوحٍ وَإِبْرَاهِيمَ وَمُوسَىٰ وَعِيسَىٰ ابْنِ مَرْيَمَ ۚ وَأَخَذْنَا مِنْهُم مِّيثَاقًا غَلِيظًا ﴿٥١﴾

[β: 51] → [LXXIII: 51]

“(Përkujto) Kur Ne e morëm (me betim) prej Pejgamberëve premtimin e tyre; edhe prej teje, prej

Nuhut, Ibrahimit, Musait, Isait birit të Merjemes, pra morëm prej tyre besë të fortë” (El Ahzab 7).

Muhammedi alejhis selam është me i miri prej të Dërguarve (resulë) dhe Vula e Pejgamberëve (nebijëve), Udhëheqësi i të devotshmëve, Zotëriu i bijëve të Ademit, Prijësi i Pejgamberëve kur të bashkohen dhe Folësi i tyre (hatibi), Pronar i Gradës së Nderit që e lakmojnë njerëzit e parë dhe të fundit, pronar i Flamurit të falenderimit dhe Haudit³² të pashtershëm, Ndërmjetësues i krijesave. E dërgoi Allahu me sheriatin më të mirë, e bëri popullin e tij, popullin me të mirë që doli prej njerëzve, i përmbledhi tek ai dhe te populli i tij vlerat dhe mirësitë, që i dalloi me popujt para tyre, ata janë populli i fundit i krijuar dhe populli i parë që ringjallet.

Thotë i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “Jam veçuar prej të Dërguarve tjerë me gjashtë gjëra” (Muslimi). Gjithashtu ka thënë, paqja dhe shpëtimi qofshin për të: “Unë jam zotëriu i bijëve të Ademit në Ditën e Kijametit, e në dorën time do të jetë flamuri i falenderimit, pa mburrje. E nuk do të ketë ndonjë të dërguar atë ditë si Ademit e të tjerët, veçse do të jetë nën flamurin tim, Ditën e Kijametit” (Transmetojnë Ahmedi dhe Tirmidhiu).

E pas të Dërguarit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem me vlerë është Ibrahimit alejhis selam i dashuri i Mëshiruesit³³, e këta dy të dashur janë më të dalluarit prej Pejgamberëve të Vendosur, e mandej vijnë ata tre tjerët pas tyre.

9. Shenjat (mrekullitë- muxhizet) e të Dërguarve alejhimus selam

³² Burimi i Pejgamberit në botën tjetër

³³ Halilur Rahman (i dashur i Mëshiruesit, i Allahut)

Allahu i përforcoi të Dërguarit e Tij, paqja e shpëtimi qofshin për ta, me shenja të mëdha e mrekulli të çuditshme, që t’ju shërbejnë si argument apo nevojë. Prej tyre është Kur’ani Fisnik, ndarja e hënës, shndërrimi i shkopit në gjarpër, krijimi i zogjëve nga dheu e të tjera. Mrekullitë jo të zakonshme janë argument i vërtetshmërisë së Pejgamberisë, e kerametet³⁴ janë argument për besimin e personit (prezent) në vërtetshmërinë e Pejgamberisë. Thotë Allahu i Madhëruar:

اَلْقَدْ اَرْسَلْنَا رُسُلَنَا بِالْبَيِّنَاتِ... ﴿٢٥﴾

“Ne i dërguam të Dërguarit Tonë me dokumente të qarta...” (El Hadid 25). Thotë i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “Nuk ka ndonjë të dërguar veçse t’i është dhënë ndonjë shenjë që në bazë të saj t’i besojnë njerëzit, e me të vërtetë ajo që më është dhënë mua (si shenjë e mrekulli), është shpallja që më zbriti (Kur’ani), e shpresoj që të jem më i pasuari në Ditën e Kijametit” (Buhariu e Muslimi).

10. Besimi në Pejgamberinë e të Dërguarit tonë Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem

Besimi në Pejgamberinë e tij sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem është themel i madh prej themeleve të imanit, e nuk realizohet imani pa të, thotë Allahu i Lartësuar:

اَوْمَنَ لَّمْ يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ فَاِنَّا اَعْتَدْنَا لِلْكَافِرِينَ سَعِيرًا ﴿٢٦﴾

.[YX: ﴿٢٦﴾]

³⁴ Përjetimi i çudirave nga besimtarët

“E kush nuk i besoi Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Ne pra, për jobesimtarët kemi përgatitur zjarr shumë të fortë” (El Fet’h 13).

Thotë i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: ”Jam urdhëruar që t’i luftoj njerëzit derisa të dëshmojnë se nuk meriton kush adhurim pos Allahut dhe se unë jam i Dërguari i Allahut” (Muslimi).

Nuk plotësohet besimi në të sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem pa disa çështje e prej tyre:

E para-Njohja e të Dërguarit tonë Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e ai është Muhammedi djali i Abdullahut, birit të Abdulmutalibit, birit të Hashimit, e Hashimi ishte prej fisit Kurejsh, e Kurejshitët janë arabë, e arabët janë prej pasardhësve të Ismailit birit të Ibrahim Halilit paqja e shpëtimi i Zotit qofshin për të dhe për të Dërguarin tonë. Ka jetuar 63 vite, 40 para Pejgamberisë dhe 23 vite si Pejgamber nebij dhe resul.

E dyta-Vërtetimi i tij në atë që na lajmëroi, respektimi i tij në atë që na urdhëroi, largimi nga ajo që na ndaloj dhe adhurimi i Allahut me atë që ai e ligjësoi.

E treta-Bindja se ai është i dërguar i Allahut te xhindët dhe njerëzit e secili prej tyre duhet ta pasojë. Thotë i Lartësuari:

اَقُلْ يٰٓاَيُّهَا النَّاسُ اِنِّى رَسُوْلُ اللّٰهِ اِلَيْكُمْ جَمِيعًا ... ﴿٢١٣﴾

[YQ: ﴿٢١٣﴾]

“Thuaj (Muhammed): “O ju njerëz! Unë jam i Dërguari i Allahut te të gjithë ju...” (El A’raf 158).

E katërta-Besimi në shpalljen e tij dhe se ai është më i miri Pejgamber dhe vula e tyre. Thotë i Lartësuari:

ا...وَلٰكِنْ رَّسُوْلَ اللّٰهِ وَخَاتَمَ النَّبِيِّنَّ... ﴿٢١٤﴾

“...ai ishte i Dërguari i Allahut dhe vulë e të gjithë Pejgamberëve...” (El Ahzab 40).

(Besimi se) Ai është i dashuri i Mëshiruesit, zotëriu i bijëve të Ademit, pronar i ndërmjetësimit të madh, i veçuar me gradën e nderit që është grada më e lartë në Xhennet, pronar i Haudit të pashtershëm, dhe se populli i tij është populli më i mirë. Thotë Allahu i Lartësuar:

اٰكُنْتُمْ خَيْرَ اُمَّةٍ اُخْرِجَتْ لِلنَّاسِ... ﴿١١٠﴾ [YIT: ﴿١١٠﴾]

“Je jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve...” (Ali Imran 110). Populli i tij është edhe më i madhi prej banorëve të Xhennetit dhe shpallja e tij është anuluese e shpalljeve të mëparshme.

E pesta-Allahu e përforcoi me mrekullinë më të madhe dhe shenjë më të qartë, e ajo është Kur’ani i Madhërueshëm, Fjala e Allahut e ruajtur nga ndryshimet. Thotë i Lartësuari:

اِقْلُ لِّئِنْ اٰجْتَمَعَتِ الْاِنْسُ وَالطُّنُّ عَلٰى اَنْ يَّاتُوْا بِمِثْلِ هٰذَا الْقُرْاٰنِ لَا يَأْتُوْنَ بِمِثْلِهٖ وَلَوْ كَانَتْ بَعْضُهُمْ لِبَعْضٍ ظٰهِرًا ﴿١١١﴾ ﴿١١١﴾ [YY: ﴿١١١﴾]

“Atë ditë peshimi (masa) është i drejtë. Atij që i rëndohen peshojat, ata janë të shpëtuar. Kujt i vijnë lehtë peshojat, ata e humben vetveten, ngase i refuzuan argumentet Tona me të padrejtë” (El A’raf 8-9).

Thotë i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “Pastërtia është gjysma e imanit, ndërsa elhamdulillah (falënderimi Allahut) e mbush peshojen” (Muslimi).

Gjithashtu thotë sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “Vendoset peshoja në Ditën e Kijametit, e edhe sikur të

peshoheshin në të qiejt dhe toka do të mjaftonte” (El Hakim).

E nënta- Sirati. Besojmë në Siratin, e Sirati është urë që shtrihet mbi Xhehennem dhe është vendkalim i frikshëm dhe i tmerrshëm. Kalojnë njerëzit mbi të (për të shkuar) drejt Xhenetit. Dikush kalon në të shpejt sa lëvizja e qerpikëve, dikush si reja, dikush si era, dikush si zog, dikush si kuajt fisnikë, e dikush duke vrapuar. E kalimtarët tjerë ka prej tyre që tërheqen zvarrë në të, kalojnë në bazë të veprave të tyre, derisa të kalojë personi që drita (e imanit) të tij është sa gishti i vogël i këmbës, e ka që edhe hidhen e bien në Zjarr, e kush e kalon Siratin hyn në Xhenet.

I pari që kalon në të është i Dërguari jonë Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, mandej ummeti i tij, e nuk flet atë ditë askush përveç Pejgamberëve, e lutja e Pejgamberëve atë ditë do të jetë: “O Allahu im, shpëtim, shpëtim”. Në Xhehennem ka gremça që gjenden në të dy anët e Siratit, nuk e din madhësinë e tyre askush përveç Allahut azze ve xhel-le, e hedhin kënd të dojë Allahu prej krijesave të Tij.

Cilësitë e tij: Është më i mprehtë se shpata, më i hollë se qimja e flokut, i rrëshqitshëm, nuk qëndron në të këmba e askujt përveç e atij që e ka përfocuar Allahu, është i kapluar me errësirë, dërgohen amaneti dhe lidhjet farefisnore e qëndrojnë rrëzë Siratit, si dëshmi për ata që i kanë zbatuar apo i kanë lënë ato.

Thotë Allahu i Lartësuar:

وَإِنْ مِنْكُمْ إِلَّا وَارِدُهَا كَانَ عَلَى رَبِّكَ حَتْمًا مَقْضِيًّا ﴿٧١﴾ ثُمَّ

نُطِّي الْأَذِينَ اتَّقَوْا وَنَذَرُ الظَّالِمِينَ فِيهَا جِثِيًّا ﴿٧٢﴾ ﴿٧٣﴾

.[٢٠٤٣٧: ﴿٧١﴾ ﴿٧٢﴾ ﴿٧٣﴾]

“Dhe nuk ka asnjë prej jush që nuk do t’i afrohet atij. Ky (kalim afër Xhehennemit) është vendim i kryer i Zotit tënd. Pastaj, (pas kalimit pran tij) do t’i shpëtojmë ata që ishin ruajtur (mëkateve), e zullumqarët do t’i lëmë aty të gjunjëzuar” (Merjem 71-72).

Thotë i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “Sjellet Sirati mes dy krahëve të Xhehennemit, e unë me ummetin tim do të jemi të parët që do ta kalojmë (e do të shpëtojmë)” (Muslimi).

Gjithashtu thotë sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “Sjellet ura e Xhehennemit, e jam unë me ummetin tim që kalojmë të parët, e lutja e Pejgamberëve atë ditë do të jetë: O Allahu im, shpëtim, shpëtim” (Buhariu dhe Muslimi).

Thotë Ebu Seid el Hudrij radijall-llahu anhu: “Më ka lajmëruar se ura është më e hollë se qimja e flokut dhe më e mprehtë se shpata” (Muslimi).

Gjithashtu ka thënë i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “Do të dërgohen amaneti dhe lidhjet farefisnore, e do të qëndrojnë rrëzë Siratit në të djathtë e të majtë, e kalon i pari prej jush si reja... mandej si era, mandej si zogu, duke u shtyrë nga veprat e tyre, e i Dërguari juaj do të qëndrojë mbi Sirat duke thënë: ‘Zoti im, shpëtim, shpëtim’ derisa ta mundësojnë këtë veprat e robëve, mandej vjen njeriu i cili nuk mundet të kalojë veçse zvarrë, e në dy anët e Siratit ka gremça të varur, që marrin ata që janë të urdhëruar, e ka prej tyre që do të jenë të lidhur nëpër gremça por shpëtues prej Zjarrit e ka tjerë që do të jenë të varur” (Muslimi).

E dhjeta- Kantare. Besojmë se besimtarët nëse e kalojnë Siratin do të ndalen në Kantare. Kantare është vend mes Xhenetit dhe Zjarrit, ku ndalen besimtarët të cilët e kanë kaluar Siratin dhe kanë shpëtuar prej Zjarrit, që t’i marrin hakin njëri tjetrit para hyrjes në Xhenet, e pasi të pastrohen u lejohet hyrja në të.

Thotë i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “Shpëtojnë besimtarët prej Zjarrit e mandej ndalen në Kantare mes Xhennetit e Zjarrit, e marrin hakun njëri tjetrit për padrejtësitë që kanë qenë mes tyre në Dunja. Pasiqë të pastrohen u lejohen atyre që të hyjnë në Xhennet...” (Buhariu).

E njëmbëdhjeta- Xhenneti dhe Xhehennemi.
Besojmë se Xhenneti është i vërtetë dhe se Xhehennemi është i vërtetë, që të dy ekzistojnë e nuk kanë fund, përkundrazi janë të përhershëm. Begatitë e banorëve të Xhennetit nuk përfundojnë, e dënimi i banorëve të Zjarrit për ata që janë gjykuar nga Allahu me përjetësi (në të), nuk kalon e as nuk ndërprehet. E besimtarët në Zotin Një, nxjerren nga ai (Zjarri), me ndërmjetësim të ndërmjetësuesve dhe me mëshirën e më të Madhit Mëshirues.

Xhenneti është shtëpia e nderit që e ka caktuar Allahu për të devotshmit në Ditën e Kijametit. Në të rrjedhin lumenjtë, ka dhoma të larta, gra të bukura (hyrija), ka në të çka mallëzohen shpirtërat dhe kënaqen sytë prej asaj që syri kur nuk e ka parë, e as veshi nuk e ka dëgjuar, e as që dikush e ka imanigjuar. Nuk kalon e as nuk përfundon begatia e tij, është e gjithmonshme e pa ndërprerje. Era e tij dëgjohet në largësi të dyzet viteve, e më e madhja begati në të është të pamurit e Allahut nga besimtarët me sytë e tyre.

Qafirët janë të privuar nga të pamurit e Allahut. E kush e mohon të pamurit e Allahut nga besimtarët, ai i ka barazuar ata me qafirët në këtë ndalesë.

Në Xhennet ka 100 shkallë, mes secilës shkallë ka hapësirë sa prej tokës e në qiell, e shkalla më e lartë është Firdeusi i Lartë. Kulmi i Xhennetit është Arshi i Mëshiruesit. Xhenneti i ka tetë dyer, e mes dy anëve të secilës derë ka hapësirë sa prej Mekkes e deri në Hixhër, e

një ditë do të jetë i mbushur, e më i ulti prej banorëve të Xhenetit do të ketë (pronë) sa dhjetë herë toka.

Thotë Allahu i Lartësuar për Xhenetin se është:

أُعِدَّتْ لِلْمُتَّقِينَ ﴿١٣٣﴾ [XXX: ﴿١٣٣﴾]

“...i përgatitur për të devotshmit” (Ali Imran 133).

Për përjetësinë e banorëve të Xhenetit dhe se ai nuk ka mbarim, Allahu xhel-le shanuhu thotë:

أَجْزَأُوهُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ جَنَّاتُ عَدْنٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ
خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ ذَلِكَ لِمَنْ خِزِي
رَبُّهُ ﴿١٣٤﴾ [Y: ﴿١٣٤﴾]

“Shpërblimi për ta te Zoti i tyre: Xhenetet e Adnit nëpër të cilët burojnë lumenj, e aty janë përgjithmonë, pakëputur. Allahu është i kënaqur ndaj tyre, e edhe ata të kënaqur prej Tij. E ky është për atë, që i ka pasur dronë Zotit të vet” (El Bejjine 8).

Xhehennemi (Zjarri) është shtëpia e dënimit që e ka caktuar Allahu për qafirët dhe mëkatarët. Në të gjendet mundimi më i rëndë dhe dënimet e llojllojshme. Rrojtaret e tij janë melekët e ashpër dhe të rreptë. Qafirët janë përgjithmonë në të, ushqimi i tyre është Zekkumi⁵⁶ e pija e tyre është gjaku i qelbosur. Zjarri i Dunjasë është një pjesë nga shtatëdhjetë pjesët e nxehtësisë së Xhehennemit. E Xhehennemi ka gjashtëdhjetë e nëntë pjesë, të gjitha sikur zjarri i Dunjasë bile edhe më shumë⁵⁷.

⁵⁶ Zekkumi është pemë e Xhehennemit me frute shumë të pakëndshme, që sikur një frut të hidhej në det do ta qelbësonte atë.

⁵⁷ Zjarri i Xhehennemit djeg 70 herë më shumë se zjarri i Dunjasë.

Xhehennemi nuk ngopet me gjithë ata që i hedhin në të, përkundrazi thotë se a ka të tjerë. I ka shtatë dyer dhe secila derë ka pjesën e vet të veçantë.

Thotë Allahu teala për Zjarrin se:

أُعِدَّتْ لِلْكَافِرِينَ ﴿١٣١﴾ [YXY: ﴿١٣١﴾]

“...është përgaditur për pabesimtarët” (Ali Imran 131).

Thotë Allahu dhul xhelal rreth qëndrimit të gjithmonshëm të banorëve të tij në të dhe se ai nuk është kalimtar:

إِنَّ اللَّهَ لَعَنَ الْكَافِرِينَ وَأَعَدَّ لَهُمْ سَعِيرًا ﴿١٤٠﴾ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا... ﴿١٤١﴾ [αααψ: ﴿١٤٠﴾]

“Allahu i ka mallkuar jobesimtarët dhe për ta ka përgatitur zjarr të ndezur fort. Aty do të mbesin përgjithmonë...” (El Ahzab 64-65).

3.Frytet e besimit në Ditën e Fundit

Besimi në Ditën e Fundit ka fryte të rëndësishme, ja disa prej tyre:

- 1.Dëshira për bërjen e veprave të mira dhe përkujdesja (që të mos i lëshojmë) duke shpresuar shpërblimin.
- 2.Droja nga bërja e mëkateve apo të kënaqurit me to, duke u frikësuar prej dënimit të asaj dite.
- 3.Ngushllimi i besimtarit për atë që i kalon në këtë botë⁵⁸, me begatitë që i shpreson prej asaj bote dhe shpërblimeve të saj.
- 4.Besimi në ringjallje është esenca e lumturisë së individit dhe shoqërisë. Njeriu nëse beson se Allahu i Lartësuar do t'i ringjallë krijesat pas vdekjes së tyre; do t'i gjykojë dhe

⁵⁸ Me atë që nuk e ka në këtë botë, siç është luksi apo gjërat e ndaluara.

shpërblejë sipas veprave të tyre; do t'i mirret haku zullumqarit prej atij që i ka bërë zullum bile edhe haku i shtazëve; (njeriu) do të qëndrojë në respektimin e Allahut, do të këputet filli i së keqes, shpërndalet e mira në shoqëri, e cila kaplohet prej vlerave dhe qetësisë.

Kushti i gjashtë: Besimi në Kader

1. Përkufizimi i Kaderit dhe rëndësia e besimit në të

Kaderi⁵⁹ është caktimi i Allahut për ndodhitë, ashtu si është paraprirë në diturinë e Tij dhe siç është përfshirë në

⁵⁹ Paracaktimi hyjnor i të gjitha gjërave para krijimit të tyre, shkruar në Librin e Ruajtur Hyjnor të Vendimeve për çdo ndodhi të çdo gjëje.

urtësinë e Tij. E gjithë kjo i takon fuqisë së Tij sepse Ai është i fuqishëm mbi çdo gjë dhe bën ç'të dojë.

Besimi në Kader është prej besimit në Zotërimin e Allahut subhanehu ve teala dhe është një nga kushtet e imanit që janë të domosdoshme për plotësimin e imanit. Thotë Allahu i Lartësuar:

إِنَّا كُلَّ شَيْءٍ خَلَقْنَاهُ بِقَدَرٍ ﴿٤٩﴾ ﴿٤٨﴾ [48: ﴿٤٨﴾]

“Ne çdo send e kemi krijuar me Kader” (El Kamer 49).

Thotë Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “Çdo gjë ndodh me Kader, bile edhe e pamundshmja dhe e mundshmja, ose e mundshmja dhe e pamundshmja” (Muslimi).

2.Shkallët e Kaderit

Besimi në Kader nuk plotësohet pa i realizuar katër shkallë:

E para: Besimi në dijen e hershme⁶⁰ të Allahut, dije që përfshin çdo gjë. Thotë Allahu i Lartësuar:

أَلَمْ تَعْلَمْ أَنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ مَا فِي السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ إِنَّ ذَلِكَ فِي كِتَابٍ إِنَّ ذَلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرٌ ﴿٧٠﴾ ﴿٧١﴾ [βT: ﴿٧١﴾]

“A nuk e ke ditur se Allahu di çka ekziston në qiell e në tokë, e tërë ajo është e shënuar në libër, ajo për Allahun është shumë lehtë” (El Haxhxxh 70).

E dyta: Besimi në shkrimin në Leuhi Mahfudh (Libri i Ruajtur Hyjnor i Vendimeve) i të gjithë caktimeve që i ka ditur Allahu. Thotë Allahu xhel-le shanuhu:

أَمَّا فَرَطُنَا فِي الْكِتَابِ مِنْ شَيْءٍ... ﴿٧٢﴾ [Xy: ﴿٧٢﴾]

⁶⁰ Dija e Allahut para krijimit të krijesave, fjala është për Ezelin

“...Ne nuk kemi lënë pas dore asgjë në Libër...” (El En’am 38).

Thotë i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “I shkroi Allahu kaderet e krijesave para se t’i krijonte qiejt dhe tokën për pesëdhjetë mijë vjet” (Muslimi).

E treta: Besimi në dëshirën e zbatueshme të Allahut dhe në fuqinë e Tij absolute. Thotë Allahu i Madhëruar:

﴿ ۞ وَ مَا تَشَاءُونَ اِلَّا اَنْ يَشَاءَ اللّٰهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ ۝۱۹ ﴾

[﴿ ۞﴾→

“E ju nuk do të dëshironi, po të mos jetë se dëshiron Allahu, Zoti i botëve” (Et Tekvir 29).

I ka thënë Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem personit që i tha ‘Çka të dëshirojë Allahu dhe ti’: “A i bëre Allahut shok? Por (thuaj) çka të dëshirojë Allahu i Vetëm” (Ahmedi).

E katërta: Besimi se Allahu është Krijues i çdo gjëje. Thotë Allahu i Lartësuar:

﴿ ۞ اَللّٰهُ خَلِقُ كُلِّ شَيْءٍ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ وَكِيلٌ ۝۲۰ ﴾

[﴿﴾→

“Allahu është krijues i çdo sendi dhe Ai ëshë mbikëqyrës ndaj çdo gjëje” (Ez Zumer 62).

﴿ ۞ وَاللّٰهُ خَلَقَكُمْ وَ مَا تَعْمَلُونَ ۝۹۱ ﴾ [﴿﴾→

“E Allahu ju krijoi juve edhe atë që e punoni” (Es Saffat 96).

Thotë i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “Allahu krijon çdo sajues dhe atë që e sajon ai” (Buhariu).

3.Ndarja e caktimeve

A.Caktimi i përgjithshëm për të gjitha ndodhitë. Ky është ai që u shkrua në Leuhi Mahfudh, para krijimit të qiejve dhe tokës për 50 mijë vjet.

B.Caktimi jetësor. Ky është caktimi i çdo gjëje që i ndodhë robit prej futjes së shpirtit e deri në vdekjen e tij.

C.Caktimi vjetor. Ky është caktimi i asaj që ndodhë çdo vit, caktim ky që bëhet Natën e Kadrit⁶¹ për çdo vit. Thotë Allahu teala:

اٰفِيهَا يُفَرَّقُ كُلُّ اَمْرٍ حَكِيْمٍ ﴿٢١﴾

“Në atë (natë) zgjidhet çdo çështje në mënyrë të prerë” (Ed Duhan 4).

Ç.Caktimi ditor. Ky është caktimi i çdo ndodhie ditore, si krenaria, poshtërimi, dhënia, ndalesa, lindja, vdekja e të tjera. Thotë Allahu i Lartësuar:

اٰيَسْأَلُهُ مَنْ فِي السَّمٰوٰتِ وَالْاَرْضِ كُلَّ يَوْمٍ هُوَ فِي شَأْنٍ ﴿٢٢﴾

.[٢٢: ﴿٢٢﴾]

“Atij i drejtohet me lutje kush është në qiej e në tokë dhe Ai në çdo moment është i angazhuar në çështje të reja (falë mëkate, largon brengosje, jep jetë, jep vdekje, krijon gjendje, zhduk të tjera etj.)” (Er Rahman 29).

4.Besimi i selefit⁶² në Kader

Allahu është Krijues, Zot dhe Pronar i çdo gjëje. Ka caktuar kaderet e krijesave para se t'i krijonte, i caktoi atyre

⁶¹ Nata e Kadrit është në muajin e Ramazanit, por nuk dihet saktësisht se cila natë është, mirëpo dihet se është njëra nga këto: 21, 23, 25, 27 dhe 29.

⁶² Selefi janë të parët tanë, gjeneratat e para myslimane, ku bëjnë pjesë Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem me shokët e tij dhe ata që i pasuan ata me bëmirësi.

afatet (se sa do të jetojnë), furnizimin, veprat dhe caktoi se a do të jenë të lumtur apo do të jenë të dëshpëruar, e çdo gjë e evidentoi në Leuhi Mahfudh. Ajo që e dëshiroi Allahu ndodhë, e ajo që nuk e dëshiroi nuk ndodhë. E din se çka ka ndodhë e çka do të ndodhë, e sikur të ndodhte si do të ndodhte. Ai është i fuqishëm për çdo gjë, e udhëzon kënd të dojë dhe e humb kënd të dojë. Robërit kanë dëshirë e fuqi që punojnë sipas saj, brenda asaj që u caktoi Allahu dhe besojnë se robët nuk dëshirojnë përveç nëse dëshiron Allahu. Thotë Allahu teala:

اَوَلَّذِينَ جَاهَدُوا فِينَا لَنَهْدِيَنَّهُمْ سُبُلَنَا... ﴿٦٩﴾

.[ad:↔→]

“E ata, të cilët luftuan për hir Tonë, Ne, me siguri do t’i orientojmë rrugës për te Ne...” (El Ankebut 69).

Allahu i Madhëruar është Krijues i robëve dhe i veprave të tyre, e ata janë kryesit e vërtetë të atyre veprave, e nuk ka arsyetim për askend para Allahut për ndonjë obligim që nuk e ka kryer apo për një ndalesë që e ka bërë, përkundrazi, Allahu ka argument të fortë kundër njerëzve. Arsyetimi me Kader lejohet vetëm për fatkeqësi e jo edhe për turpe e mëkate. Tregon Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem rreth Ademit dhe Musait alejhimas selam: “Polemizuan Ademi dhe Musa. Tha Musa: Ti je Ademi që mëkati yt të nxorri nga Xhenneti. I tha Ademi: Ti je Musa që të zgjodhi Allahu për shpalljen e Tij dhe Fjalën e Tij, e mandej më akuzon mua për një çështje që është caktuar për mua para se të krijohem. Kështu u arsyetua Ademi para Musait” (Muslimi).

5.Veprat e njerëzve

Veprat të cilat i krijoi Allahu i Lartësuar në gjithësi ndahen në dy grupe:

I pari: Veprat e Allahut tebareke ve teala në krijesat e Tij, e nuk ka të drejtë askush në to që të dëshirojë apo të zgjedhë, por, ato janë sipas dëshirës së Allahut, siç janë jeta, vdekja, sëmundja dhe shëndeti. Thotë i Lartësuari:

اِنَّ اللّٰهَ خَلَقَكُمْ وَمَا تَعْمَلُونَ ﴿٩٦﴾ ﴿٩٦﴾

“E Allahu ju krijoi juve edhe atë që e punoni” (Es Saffat 96).

اَلَّذِي خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيٰوةَ لِيَبْلُوَكُمْ اَيُّكُمْ اَحْسَنُ عَمَلًا ﴿٩٧﴾ ﴿٩٧﴾

﴿٩٧﴾ ﴿٩٧﴾

“Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën, për t’ju provuar se cili prej jush është më vepërmirë...” (El Mulk 2).

I dyti: Veprat që i punojnë krijesat me dëshirën e tyre. Këto vepra bëhen me zgjedhje të atyre që i veprojnë dhe sipas dëshirës së tyre, pasi që Allahu ju dha këtë mundësi. Allahu xhel-le shanuhu thotë:

اَلِمَنْ شَآءَ مِنْكُمْ اَنْ يَّسْتَقِيْمَ ﴿٢٨﴾ ﴿٢٨﴾

“Për atë nga mesi që dëshiron të gjendet në të vërtetën” (Et Tekvir 28).

اَفَمَنْ شَآءَ فَلْيُؤْمِنْ وَمَنْ شَآءَ فَلْيُكْفُرْ ... ﴿٢٩﴾ ﴿٢٩﴾

﴿٢٩﴾ ﴿٢٩﴾

“...E vërteta është nga Zoti juaj, e kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë...” (El Kehf 29).

Ata (njerëzit) do të falenderohen për veprat e lavdëruara dhe do të qortohen për veprat e qortueshme, e Allahu nuk dënon veçse për çështjet në të cilat ka lënë mundësi zgjedhjeje për njerëzit. Siç thotë Allahu teala:

ا... وَمَا أَنَا بِظَالِمٍ لِلْعَبِيدِ ﴿٢٩﴾ ﴿٢٨﴾ [Q6: ﴿٢٨﴾ ﴿٢٩﴾]

“...dhe Unë nuk jam zullumqar për robërit” (Kaf 29).

Njeriu e din dallimin mes zgjedhjes dhe detyrimit, p.sh. njeriu zbret nga kulmi me shkallë, zbritje kjo që e zgjedh vet, por, mundet që ta rrëzojë dikush nga kulmi. E para ishte zgjedhje e e dyta ishte detyrim.

6. Pikat e përbashkëta mes krijimit të Allahut dhe veprës së robit

Allahu krijoi robin dhe krijoi veprat e tij. I dha atij dëshirë dhe mundësi. Robi është veprues direkt dhe i vërtetë i veprës së tij, pasiqë ka dëshirë dhe mundësi. Kështu nëse beson, kjo është me dëshirën dhe mundësinë e tij, e nëse mohon, ai është qafir me dëshirën e tij të plotë. Kjo është sikur të themi: Ky frut është prej kësaj peme, ky produkt është prej tokës, që domethënë se është dalë nga ajo, e edhe nga Allahu që domethënë se Ai e krijoi (atë frut) prej saj. Këtu nuk ka aspak kundërthënie, këtu përputhen Ligji i Allahut dhe Kaderi i Tij.

Thotë Allahu subhanehu ve tealat:

ا وَاللَّهُ خَلَقَكُمْ وَمَا تَعْمَلُونَ ﴿٩٦﴾ ﴿٩٥﴾ [Safat: ﴿٩٥﴾ ﴿٩٦﴾]

“E Allahu ju krijoi juve edhe atë që e punoni” (Es Saffat 96).

ا فَأَمَّا مَنْ أُعْطِيَ وَاتَّقَى ﴿٩٦﴾ وَصَدَّقَ بِالْحُسْنَى ﴿٩٥﴾ فَسَنُيَسِّرُهُ

لِلْيُسْرَى ﴿٩٧﴾ وَأَمَّا مَنْ بَخِلَ وَاسْتَغْنَى ﴿٩٨﴾ وَكَذَّبَ بِالْحُسْنَى ﴿٩٩﴾

﴿١٠٠﴾ فَسَنُيَسِّرُهُ لِلْعُسْرَى ﴿١٠١﴾ ﴿١٠٢﴾ [YT- Q6: ﴿١٠٢﴾ ﴿١٠١﴾]

“E, sa i përket atij që jep dhe ruhet, dhe vërteton bindshëm për më të mirën, Ne do ta përgatitim atë për më të lehtë. E sa i përket atij që bën koprraci dhe ndien veten të pavarur (nga Zoti) dhe që përgënjeshton atë më të mirën, Ne do ta përgatisim për më të vështirën” (El Lejl 5-10).

7.Obligimi i njeriut rreth Kaderit

Obligohet njeriu rreth Kaderit me dy çështje:

E para: Të kërkojë ndihmë nga Allahu në kryerjen e veprave të lejuara dhe në largimin prej veprave të ndaluara. Të e lus Atë që t’ia lehtësojë e t’ia largojë vështirësitë, të mbështetet në Të e të kërkojë mbrojtje prej Tij, e kështu është i nevojshëm për të në kryerjen e të mirës e lënien e së keqes. Thotë Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “Kujdesu për atë që të sjell dobi. Kërko ndihmë nga Allahu e mos u bëj i dobët. Nëse të godet diçka, mos thuaj: sikur të veproja kështu, do të ndodhte kjo, por thuaj: Allahu e ka caktuar dhe çka ka dashur Ai ka vepruar. Sepse "lev-i" (sikur të...) e fillon veprimin e djallit”.

E dyta: Duhet të durojë në atë që e ka të caktuar e të mos dobësohet. Ta dijë se ajo është prej Allahut, të kënaqet e të dorëzohet. Ta dijë se ajo që e goditi, nuk do të mund të shmangej, e as ajo që është shmangur nuk do ta godasë. Thotë i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “Dije se ajo që të ka goditur nuk do të mund të shmangej, e as ajo që të është shmangur, nuk do të godiste”.

8.Të kënaqurit me Gjykimin dhe Kaderin

Duhet të kënaqemi me Kaderin sepse është prej plotësimit të kënaqësisë me Zotërimin e Allahut. Duhet që

secili besimtarë të kënaqet me gjykimin e Allahut, se ajo që e ka bërë Allahu dhe gjykimi i Tij është e tëra hajr, drejtësi dhe urtësi. Atij që i është qetësuar shpirti i tij në atë se ajo që e ka goditur nuk do të mundte të shmangej, e as ajo që është shmangur nuk do ta godasë; e ka shpëtuar shpirtin e tij prej lëkundjeve; e ka larguar prej jetës së tij brengosjen dhe kundërthënien; nuk pikëllohet për atë që i ka kaluar, e as nuk frigohet për të ardhmen e tij. Me këto ky është njeriu më i lumtur, shpirtërisht më i miri dhe më i qeti. Ai i cili e kupton se afati (jetësor) i tij është i caktuar, rizku i tij i numëruar, se frika nuk mund t'ia zgjasë jetën, e as kopracia nuk mund t'ia shtojë rizkun dhe çdo gjë është e shkruar; duron sprovat që e kanë goditur, i kërkon falje Allahut për gabimet dhe turpet që i ka bërë, kënaqet me atë që i ka caktuar Allahu; e me këtë bashkon respektimin e urdhërit dhe durimin përballë sprovave.

Thotë Allahu xhel-le xhelaluhu:

أَمْ أَصَابَ مِنْ مُصِيبَةٍ إِلَّا بِإِذْنِ اللَّهِ وَمَنْ يُؤْمِنُ بِاللَّهِ يَهْدِ اللَّهُ قَلْبَهُ وَاللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴿١١﴾

“Çfarëdo e keqe që ndodh (godet), nuk mund të jetë ndryshe, vetëm sipas caktimit të Allahut, e kush i beson Allahut, Ai ia udhëzon zemrën e tij; Allahu është i gjithdijshtëm për çdo send” (Et Tegabun 11).

فَاصْبِرْ إِنَّ وَعْدَ اللَّهِ حَقٌّ وَأَسْتَغْفِرْ لِذَنْبِكَ ﴿١٢﴾

“Ti bën durim, se premtimi i Allahut është i vërtetë, kërko falje për mëkatin tënd...” (Gafir 55).

9.Udhëzimi është dy llojesh

I pari: Udhëzimi me argumentimin e të vërtetës dhe orientimit në të. Ky udhëzim është për të gjitha krijesat dhe këtë e kanë mundësi Pejgamberët dhe pasuesit e tyre. Thotë Allahu i Madhëruar:

وَإِنَّكَ لَتَهْدِي إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ﴿٥٢﴾ ﴿٥٢﴾

“...Në të vërtetë, edhe ti udhëzon për në rrugën e drejtë” (Esh Shura’ 52).

I dyti: Udhëzimi me sukses dhe përforsim prej Allahut, bëmiresi prej Tij dhe nderë për robët e Tij të devotshëm. Ky udhëzim është vetëm në mundësinë e Allahut. Thotë Allahu dhul xhelal:

إِنَّكَ لَا تَهْدِي مَنْ أَحْبَبْتَ وَلَكِنَّ اللَّهَ يَهْدِي مَنْ يَشَاءُ ﴿٥٦﴾ ﴿٥٦﴾

“Është e vërtetë se ti nuk mund ta udhëzosh atë që do ti, por Allahu udhëzon kë të dojë...” (El Kasas 56).

10.Dëshira në Librin e Allahut është dy llojesh

I pari: **Dëshira kosmologjike e caktuese**. Kjo është dëshira absolute për të gjithë ekzistencën. Çka dëshiron Allahu bëhet e çka nuk dëshiron nuk bëhet. Kjo dëshirë e obligon plotësimin e sendit që dëshirohet, e nuk e obligon të dashurit dhe kënaqësinë, përveç nëse lidhet me dëshirën legjislative. Thotë Allahu xhel-le shanuhu:

أَفَمَنْ يُرِدِ اللَّهُ أَنْ يَهْدِيَهُ يَشْرَحْ صَدْرَهُ لِلْإِسْلَامِ... ﴿١٠٦﴾ ﴿١٠٦﴾

“Atë që Allahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për (të pranuar) islamin...” (El En’am 125).

I dyti: Dëshira fetare dhe legjislative. Kjo dëshirë është të dashurit e sendit që dëshirohet, atyre që e ndjekin atë dhe kënaqësia ndaj tyre. Kjo nuk e obligon plotësimin e sendit që dëshirohet përveç nëse është e lidhur me dëshirën kosmologjike. Thotë Allahu subhanehu ve teala:

ا...يُرِيدُ اللَّهُ بِكُمْ الْيُسْرَ وَلَا يُرِيدُ بِكُمْ الْعُسْرَ... ﴿١٢٥﴾
[YyΩ←→]

“...Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështërsim për ju...” (El Bekare 185).

Dëshira kosmologjike është më e përgjithshme sepse çdo dëshirë legjislative që ka ndodhur është njëkohësisht dëshirë kosmologjike, e çdo dëshirë kosmologjike që ka ndodhur nuk është medoemos dëshirë legjislative. P.sh. në imanin e Ebu Bekrit radijall-llahu anhu janë realizuar që të dy llojet e dëshirave. E shembull për realizimin e dëshirës kosmologjike është kufri i Ebu Xhehlit, e nuk është realizuar dëshira legjislative, pasi që është dëshiruar legjislativisht imani i tij. Pra, Allahu edhe nëse ka dëshiruar mëkatet me caktim dhe dëshirë kosmologjike, Ai nuk kënaqet me to nga aspekti fetar, nuk i don ato dhe nuk urdhëron në to. Përkundrazi i urren dhe ndalon prej tyre dhe e kërcënon mëkatarin, e e gjithë kjo është me Kaderin e Tij.

E sa i përket punëve të mira dhe imanit, Ai, i madhëruar qoftë, i don dhe urdhëron në to dhe i premtan vepruesit të tyre shpërblim të mirë. Ai, nuk mëkatnohet (prej njerëzve) veçse me dëshirën e Tij, e nuk ndodh asnjë send veçse me dëshirën e Tij. Thotë i Lartësuari:

ا وَلَا يَرْضَىٰ لِعِبَادِهِ الْكُفْرَ... ﴿١٢٦﴾ [β:←→]

“...Ai nuk është i kënaqur me mosbesimin e robërve të Vet...” (Ez Zumer 7).

اِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْفُسَادَ ﴿٢٠٥﴾

“...E Allahu nuk e do çrregullimin (fesadin)” (El Bekare 205).

11.Shkaqet të cilat e ndryshojnë Kaderin

Allahu xhel-le shanuhu ka caktuar për kaderet e veta shkaqe me të cilat ato ndryshohen dhe nuk ndodhin, e ato shkaqe janë lutja, sadakaja (lëmosha), ilaçet, marrja e masave preventive, në çdo aspekt të Kaderit të Allahut, deri edhe në pamundësi dhe mundësi.

12.Çështja e Kaderit është sekret i Allahut ndaj krijesave

Thënia se Kaderi është prej sekreteve të Allahut ndaj krijesave, është e kufizuar vetëm në anën e fshehtë të Kaderit. Realitetin e gjërave nuk e di askush përveç Allahut, e nuk arrin te to as njeriu. P.sh. Allahu i humbi dhe i udhëzoi (krijesat), ju morri dhe ju dha jetën, ju ndaloi (pasuritë) dhe ju dha. Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem thotë: “Kur të përmendet Kaderi përmbajuni (keni kujdes)” (Muslimi).

Ndërsa anët tjera të Kaderit, si urtësitë e tij të mëdha, shkallët, gradët dhe ndikimin e tij, lejohet sqarimi i tyre për njerëzit dhe njohja e tyre, sepse Kaderi është një nga kushtet e Imanit që duhet të mësohet dhe njihet.

Thotë Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kur u përmenden kushtet e Imanit para Xhibrilit alejhis

selam: “Ky është Xhibrili e ka ardhur që t’ua mësojë fenë tuaj” (Muslimi).

13.Arsyetimi me Kader⁶³

Dija e Allahut të Lartësuar për gjërat para se të ndodhin ato, është sekret që nuk e din askush përpos Tij, e panjohur për njerëzit e nuk mund të gjejë askush arsyetim (për mëkatet) e veta në të. Pra, Kaderi nuk është arsyetim për askend, qoftë para Allahut, qoftë para krijesave të Tij, e sikur t’i lejohej dikujt të arsyetohet me Kader për të këqiat që i bën, atëherë nuk do të ndëshkohej zullumqari, as nuk do të luftohej mushriku, nuk do të zbatoheshin ligjet (e dënimeve), nuk do ta ndërprente askush zullumqarin (nga padrejtësitë e tij), e ky është çrregullim në fe e në tokë, e dihet fort mirë dëmi i kësaj.

I themi atij që arsyetohet me Kader se ti nuk je aspak i sigurt se a do të jesh prej banorëve të Xhennetit apo Zjarrit, e sikur ta dije me siguri këtë, atëherë nuk do të kishim urdhëruar (për të mira) e as nuk do të kishim ndaluar (nga të këqiat), por, të themi puno (vepra të mira) me shpresë që Allahu të dhurojë sukses e të jesh prej banorëve të Xhennetit.

Ka thënë i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem kur është pyetur për arsyetimin me Kader: “Punoni, e secilit prej jush i është lehtësuar ajo për të cilën është krijuar, e kush është prej të lumturve i është lehtësuar puna e të lumturve (që shpie në lumturi), e kush është prej të dëshpruarve i është lehtësuar puna e të dëshpruarve⁶⁴” e

⁶³ Arsyetimi me Kader është të thotë dikush kur të bën ndonjë krim, se nuk duhet të dënohet sepse ajo që e ka bërë është me Kaderin e Allahut.

⁶⁴ Të lumturit janë besimtarët e të dëshpruarit janë mëkatarët

mandej e lexoi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem (Fjalën e Allahut):

ا فَاَمَّا مَنْ اَعْطٰى وَاتَّقٰى ﴿٥٠﴾ وَصَدَّقَ بِالْحُسْنٰى ﴿٥١﴾ فَسَنِيْسِرُّهٗ
لِلْيُسْرٰى ﴿٥٢﴾ وَاَمَّا مَنْ بَخِلَ وَاسْتَغْنٰى ﴿٥٣﴾ وَكَذَّبَ بِالْحُسْنٰى ﴿٥٤﴾
فَسَنِيْسِرُّهٗ لِّلْعُسْرٰى ﴿٥٥﴾ ﴿٥٦﴾

“E, sa i përket atij që jep dhe ruhet, dhe vërteton bindshëm për më të mirën, Ne do ta përgatitim atë për më të lehtë. E sa i përket atij që bën koprraci dhe ndien veten të pavarur (nga Zoti), dhe që përgënjeshtrojnë atë më të mirën, Ne do ta përgatisim për më të vështirën” (El Lejl 5-10).

14.Ndjekja e shkaqeve⁶⁵ (sebepeve)

Njeriut i paraqiten (në jetën e tij) dy çështje: Çështja në të cilën ka gjindshmëri dhe kjo nuk i pamundësohet atij dhe çështja në të cilën nuk ka gjindshmëri dhe nuk bën të ankohet për të. Allahu subhanehu ve teala i din fatkeqësitë edhe para se të ndodhin ato, e dija e Tij për to nuk është shkak që e shtyn fatkeqin në fatkeqësi, por ato ndodhin prej shkaqeve që renditet për ndodhjen e tyre. Nëse ndodhja e tyre është për shkak të moskujdesit të personit, duke i injoruar shkaqet dhe mjetet që e mbrojnë atë prej rënies në fatkeqësi, (shkaqe me të cilat) e ka urdhëruar feja e vet që t'i përdorë, atëherë ai është fajtor për pakujdesin e tij në mbrojtjen e vetvetes dhe në moskryerjen e shkaqeve të

⁶⁵ Është për qëllim, që kur dëshirojmë ta kryejmë një punë, duhet t'i ndjekim, t'i kryejmë të gjitha shkaqet që na mundësojnë kryerjen me sukses të asaj pune

natyrshme të cilat e mbrojnë atë. E nëse është i pafuqi në mbrojtjen prej fatkeqësive atëherë ai arsyetohet.

Ndjekja e shkaqeve nuk e mohon Kaderin e as mbështetjen në Allahun, e përkundrazi ajo është pjesë e tyre. Mirëpo nëse ndodhë një caktim, atëherë obligohet të jemi të kënaqur e t'i dorëzohemi atij dhe duhet të gjejmë prehje në fjalët “E bëri Allahu Kader, e çka dëshiroi Ai veptroi”. Ndërsa para ndodhjes (së caktimit të Allahut), njeriu duhet të ndjekë shkaqet e ligjshme dhe mbrojtëset prej kadereve me kadere (tjera, sepse gjithçka është me Kaderin, caktimin e Allahut). Të Dërguarit i kanë ndjekur shkaqet dhe mjetet të cilat i kanë ruajtur ata prej armiqëve të tyre, edhe pse ata kanë qenë të ndihmuar me Shpalljen dhe Mbrojtjen prej Allahut dhul xhelal. I Dërguari i Allahut, Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, zotëriu i atyre që mbështeten në Zotin, i ka ndjekur shkaqet, me gjithë forcën e mbështetjes së tij në Zotin e tij.

Thotë Allahu xhel-le shanuhu:

اَوَاعِدُوا لَهُمْ مَا اسْتَطَعْتُمْ مِنْ قُوَّةٍ وَمِنْ رِبَاطِ الْخَيْلِ

تُرْهِبُونَ بِهِ عَدُوَّ اللَّهِ وَعَدُوَّكُمْ ﴿٦٠﴾ [٢٤:٦٠]

“E ju përgatituni sa të keni mundësi force, (mjete luftarake) e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhtojnë) e me të, (me përgatitje) ta frikësoni armikun e Allahut, armikun tuaj...” (El Enfal 60).

اَهُوَ الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ ذُلُولًا فَامْشُوا فِي مَنَاكِبِهَا وَكُلُوا

مِنْ رِزْقِهِ ۚ وَإِلَيْهِ النُّشُورُ ﴿١٥﴾ [٢٥:١٥]

“Ai është që juve tokën ua bëri të përshtatshme, andaj, ecni nëpër pjesë të saj dhe shfrytëzoni begatitë e Tij, meqë vetëm te Ai është e ardhmja” (El Mulk 15).

Thotë Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “Besimtari i fortë (në besim) është më i mirë dhe më i dashur tek Allahu se sa besimtari i dobët, dhe te secili ka dobi. Kujdesu për atë që të sjell dobi. Kërko ndihmë nga Allahu e mos u bëj i dobët. Nëse të godet diçka, mos thuaj: sikur të veproja kështu, do të ndodhte kjo, por thuaj: Allahu e ka caktuar dhe çka ka dashur Ai ka vepruar. Sepse "lev-i" (sikur të...) e fillon veprimin e djallit” (Muslimi).

15.Vendimi për atë që e mohon Kaderin

Kush e mohon Kaderin, ka mohuar një themel nga themelet e Sheriatit dhe me këtë ka bërë kufër. Kanë thënë disa nga selefët: “Polemizojini kaderijët⁶⁶ me dituri, e nëse mohojnë atëherë kanë bërë kufër, e nëse janë të kënaqur (me kufër) atëherë armiqësojini”.

16.Frytet e besimit në Kader

Besimi në Kader ka fryte dhe ndikim të mirë, që ndihmojnë në përmirësimin e Ummetit dhe individit, e disa prej tyre po i përmendim më poshtë:

1.Prej (besimit në Kader) rrjedhin ibadete dhe cilësi të lavdërueshme, siç janë sinqeriteti- Ihlesi për Allahun (në të gjitha veprat); mbështetja në Allahun; frika nga Ai; shpresa dhe mendimi i mirë për Të; durimi dhe forca e përmbajtjes; luftimi i pesimizmit; kënaqja me Allahun; njësimi i Allahut në falënderim e gëzimi me begatitë dhe mëshirën e Tij; modestia për hirë të Allahut; lënia e mendjemadhësisë dhe mburrjes; e rrjedh prej dhënies (së të

⁶⁶ Kaderijët janë një sekt që e mohojnë Kaderin e që e konsiderojnë veten myslimanë. Ndikimi i tyre është prezent edhe në kohën tonë, e vlen të cekem disa hoxhallarë tanë që kanë devijuar nga kuptimi i selefët mbi Kaderin dhe mundohen që bindjet e tyre t’ia imponojnë masës e cila i kundërshton në bazë të natyrshmërisë së pastër (fitres)

hollave) për të mira të ndryshme, bindja në Allahun, trimëria; kënaqësia dhe krenaria e shpirtit; ambiciet e larta; serioziteti në çështje; durimi në skamje dhe sëmundje; shpëtimi nga zilia; lirimi i mendjes nga bindjet e botkuptimet e kota; rehatia e shpirtit dhe qetësia e zemrës.

2. Ai që beson në Kader e kalon jetën e tij në rrugë të drejtë, nuk është i pakënaqur me begatitë, nuk bëhet pesimist prej fatkeqësive, e është i bindur thellë se dëmi që e ka goditur është sprovë me Kaderin e Allahut, nuk ankohet për të, përkundrazi duron dhe shpërblehet.

3. Besimi në Kader mbronë prej shkaqeve të humbjes dhe përfundimit të keq, sepse i mbjellë atij (që beson) përpjekje të gjithmonshme për qëndrim (në rrugën e drejtë), për shtimin e punëve të mira dhe largimin nga mëkatet.

4. Besimi në Kader mbjellë tek besimtarët përballim të fatkeqësive me zemër të fortë dhe bindje të plotë duke i zbatuar shkaqet. Thotë Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “E çuditshme është çështja e besimtarit. Çështja e tij është krejt mirë për të dhe nuk është e tillë për askend tjetër. Nëse besimtarin e godet gëzimi, ai falënderon (Allahun), e kjo i sjell dobi, kurse nëse e godet e keqja, ai bën durim (sabër) andaj edhe kjo i sjell dobi” (Muslimi).⁶⁷

Fjala e përkthyesit

Nuk është hera e parë që lexuesit shqiptar i paraqitet një vepër si kjo ku janë trajtuar çështjet më të rëndësishme të fesë islame, çështjet e besimit në gjashtë të vërtetat, me të cilat na ka urdhëruar Allahu xhel-le shanuhu. Por, ky libër i shkruar nga një grup dijetarësh që japin mësim në Universitetin Islamik të Medinës është diçka i veçantë.

⁶⁷ Falënderimi i takon Allahut Zotit të botëve. U përfundua përkthimi i këtij libri (dora e parë) me 6 Safer 1423 (19 prill 2002) në Medinë.

Shpjegimet e shkurtëra e të qarta për temën të cilën e trajton, janë karakteristikë e këtij libri. Nuk e di se sa e kemi realizuar përkthimin e tij në gjuhën tonë shqipe, por besojmë se do të jeni të kënaqur. Mos harroni të na i dërgoni edhe vërejtjet tuaja, nëse keni hasur diçka të paqartë, nëse mendoni se përkthimi nuk është i qëlluar, apo nëse keni çfarëdo lloj sygjërimi. E lus Allahun e Lartësuar të na i falë mëkatet tona e të na bëjë prej atyre që e besojmë me besim të vërtetë ashtu si e besuan të Dërguarit, në krye me Muhammedin sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ashtu si e besuan shokët e tij të ndershëm, Ebu Bekri, Omeri, Othmani, Aliu e të tjerët, Allahu qoftë i kënaqur me ta. Besojmë se ne me përkthim e ju me lexim e persiatje do ta fitojmë së bashku kënaqësinë e Allahut. Falënderoj Allahun që më ndihmoi gjatë këtij përkthimi si dhe e lus Atë që ta udhëzojë në rrugë të drejtë popullin tonë.

Lulëzim Blaka

Medine 7 Safer 1423 (20 Prill 2002)

Përmbajtja e lëndës

Hyrja.....	3
Kushti i parë: Besimi në Allahun e Lartësuar.....	7
1.Realizimi i këtij besimi.....	7
2.Definicioni i ibadetit.....	20
3.Argumentet e Tevhidit.....	23
Kushti i dytë: Kushti i dytë: Besimi në melekë.....	27
1.Definicioni.....	27
2.Mënyra e besimit në melekë.....	28

3.Frytet e besimit në melekë.....	36
Kushti i tretë: Besimi në libra.....	37
1.Realiteti i besimit në libra.....	38
2.Dispozita e besimit në libra.....	38
3.Nevoja e njerëzve për libra.....	39
4.Mënyra e besimit në libra.....	40
5.Pranimi i lajmeve të librave të mëparshëm.....	42
6.Librat qiellor në Kur'an dhe Sunnet.....	44
Kushti i katërt: Besimi në të Dërguarit.....	49
1.Besimi në të Dërguar.....	49
2.Realiteti i Pejgamberisë.....	51
3.Urtësia e dërgimit të Pejgamberëve.....	51
4.Detyrat e të Dërguarve.....	53
5.Islami është feja e të gjithë Pejgamberëve.....	55
6.Të Dërguarit janë njerëz, nuk e dinë të fshehtë.....	55
7.Pagabueshmëria e Pejgamberëve.....	57
8.Numri i të Dërguarve.....	58
9.Mrekullitë e të Dërguarve.....	62
Kushti i pestë: Besimi në Ditën e Fundit.....	72
1.Besimi në Ditën e Fundit.....	72
2.Mënyra e besimit në Ditën e Fundit.....	76
3.Frytet e besimit në Ditën e Fundit.....	91
Kushti i gjashtë: Besimi në Kaderin e Allahut.....	93
1.Përkufizimi i Kaderit.....	93
2.Shkallët e Kaderit.....	93
3.Ndarja e caktimeve.....	95
4.Besimi i selefit në Kader.....	96
5.Veprat e njerëzve.....	97
6.Pikat e përbashkëta mes krijimit dhe veprës.....	98
7.Obligimi i njeriut rreth Kaderit.....	99
8.Të kënaqurit me Kaderin.....	100
9.Udhëzimi është dy llojesh.....	101
10.Dëshira është dy llojesh.....	102
11.Shkaqet që e ndryshojnë Kaderin.....	103
12.Kaderi është sekret.....	103
13.Arsyetimi me Kader.....	104
14.Ndjekja e shkaqeve.....	105
15.Vendimi për atë që e mohon Kaderin.....	107
16.Frytet e besimit në Kader.....	107
Fjala e përkthyesit.....	109

